

VALIDIMI*
I NISMES SE TRANSPARENCES SE INDUSTRISE NXJERRESE
NE SHQIPERI

Gusht 2011

Draft Raporti perfundimtar per Grupin e Punes se ALBEITI

Pergatitur nga Hart Nurse Shpk.

- *Validim: term i perdorur per te shprehur vlefshmerine e nje procesi (shen. i perkth.)*

Falenderime

Duam t'u shprehim falenderimet tona te sinqerta z. Neritan Alibali, zvMinister i Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes, z. Sokol Mati, Drejtor i Drejtorise se Politikave Industriale, z. Shkelqim Hysaj, drejtor i EITI Shqiperi, si dhe z. Agim Shehu dhe z. Albert Brojka nga Sekretariati i ALBEITI, per asistencen dhe mbeshtetjen e tyre gjate kesaj detyre. Ne u jemi mirenjohes te gjithë atyre qe ne menyre te lire ia shprehen pikepamjet e tyre ekipit te Validimit.

Shkurtime dhe Akronime

Me poshte vijon nje çeles ne shkurtimet dhe akronimet e perdorura ne kete raport:

ALBEITI	EITI Shqiptar
AFS	Deklarata financiare te audituara
AKBN	Agjensia Kombetare e Burimeve Natyrore
CSO	Organizate e Shoqerise Civile
EITI	Nisma e Transparences se Industrise Nxjerrrese
Bordi i EITI	Bordi Nderkombetar i EITI
FIAA	Shoqata e Investuesve te Huaj ne Shqiperi
INTOSAI	Organizata Nderkombetare e Institucioneve Supreme te Auditit
ISA	Standardet nderkombetare mbi Auditin
METE	Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjise
MOU	Memorandum Mirekuptimi
NGO	Organizate Jo Qeveritare
TOR	Termet e References

RAPORTI I VALIDIMIT

	Faqe
1. Hyrje	5
1.1 Parathenie	5
1.2 Procesi i Validimit EITI	5
1.3 Perafrimi dhe aktivitetet e Validimit	6
1.4 Industria Nxjerrse ne Shqiperi	6
2. Progresi perballe Planit te Punes se Vendit	19
2.1. Objektivi 1: Vendos perkushtimin per te zbatuar EITI dhe themelo nje grup pune EITI	19
2.2. Objektivi 2: Vendos, zhvillo dhe publiko ne plan pune EITI	19
2.3. Objektivi 3: Largo pengesat ndaj EITI/ndertimi i kapaciteteve dhe aksesit	20
2.4. Objektivi 4: Ploteso dhe shpernda Raportin EITI	20
2.5. Objektivi 5: Validimi i zbatimit te EITI	21
2.6. Objektivi 6: Qendrueshmeria dhe zbatimi i vijueshem i EITI	23
3. Raport mbi Progresin perkundrejt Treguesve ne Griden e Validimit	24
3.1. Treguesi 1 i Grides: A ka nxjerre Qeveria nje deklarate publike pa ekuivoke per qelimin e saj qe ta zbatoje EITI-n?	24
3.2. Treguesi 2 i Grides: A eshte Qeveria e perkushtuar qe te punoje me shoqerine civile dhe me kompanite per zbatimin e EITI?	25
3.3. Treguesi 3 i Grides: A ka caktuar Qeveria nje individ te larte per te drejtuar zbatimin e EITI?	27

- 3.4. Treguesi 4 i Grides: A eshte publikuar dhe bere gjeresisht i arritshem nje Plan Veprimi teresisht i kostuar(me kostot perkatese), i cili te permbaje objektiva te matshem, nje plan kohor per zbatimin dhe nje vleresim per kufizimet ne kapacitete(Qeveri, sektor privat dhe shoqeri civile)? 28
- 3.5. Treguesi 5 i Grides: A ka themeluar Qeveria nje grup nderinstitucional per te mbikqyrur zbatimin e EITI? 31
- 3.6. Treguesi 6 i Grides: A eshte shoqeria civile e angazhuar ne proces? 38
- 3.7. Treguesi 7 i Grides: A jane kompanite te angazhuara ne proces? 41
- 3.8. Treguesi 8 i Grides: A hoqi Qeveria ndonje pengese ne zbatimin e EITI? 45
- 3.9. Treguesi 9 i Grides: A jane miratuar formatet e raportimit? 47
- 3.10. Treguesi 10 i Grides: A eshte i kenaqur Grupi Nderinstitucional me organizaten e caktuar per te rakorduar shifrat? 50
- 3.11. Treguesi 11 i Grides: A ka siguruar Qeveria qe te gjitha kompanite do te raportojne? 51
- 3.12. Treguesi 12 i Grides: A ka siguruar Qeveria qe raportet e kompanise te jene te bazuara ne llogari te audituara sipas standardeve nderkombetare? 53
- 3.13. Treguesi 13 i Grides: A ka siguruar qeveria qe raportimet qeveritare jane te bazuara ne llogari te audituara mbi standarde nderkombetare? 55
- 3.14. Treguesi 14 i Grides: A iu dhane te gjitha pagesat materiale te naftes, gazit dhe mineraleve qe kompanite i bejne Qeverise, organizates se kontraktuar per te rakorduar shifrat dhe per te prodhuar Raportin EITI? 57
- 3.15. Treguesi 15 i Grides: A iu dhane te gjitha te ardhurat e naftes, gazit dhe mineraleve te arketuara nga Qeveria(“te ardhurat”) organizates se kontraktuar per te rakorduar shifrat dhe per te prodhuar Raportin EITI? 58
- 3.16. Treguesi 16 i Grides: A ishte Grupi Nderinstitucional i kenaqur qe organizata

e kontraktuar per te vleresuar shifrat e kompanive dhe te Qeverise veproi ne menyre kaq te suksesshme?	60
3.17. Treguesi 17 i Grides: A identifikoi mosrakordime raporti EITI 2009 dhe a dha rekomandime per veprimet qe duhen ndermarre?	61
3.18. Treguesi 18 i Grides: A u be publik Raporti EITI 2009, ne nje menyre qe te ishte publikisht i aksesueshem, i kuptueshem dhe i teresishem?	62
3.19. A e kane mbeshtetur kompanite e naftes, gazit dhe ato minerare zbatimin e EITI?	63
3.20. Cilat hapa hapa u moren per te vepruar ne baze te mesimeve te marra, per te trajtuar mosrakordimet dhe per te siguruar qe zbatimi i EITI te jete i qendrueshem?	66
4. Grida e Validimit	67
5. Konkluzionet dhe Rekomandimet	68
5.1. Konkluzion i Validatorit(Vleresuesit) mbi zbatimin e EITI ne Shqiperi	68
5.2. Rekomandime per zbatimin e metejshem te EITI ne Shqiperi	69
Shtojce	Lista e Atyre qe u pergjigjen
Vellimi 2	Apendikset

1. Hyrje

1.1 Parathenie

Ky raport paraqet gjetjet tona per zbatimin e EITI ne Shqiperi, pas nje rishikimi te dokumentacionit te siguruar dhe nje vizite ne Shqiperi ne prill 2011.

Ne i kemi bazuar konkluzionet tona mbi informacionin paraprak te siguruar me 28 prill 2011 dhe mbi raportin final 2009 te rakordimit te pagesave, te miratuar nga Grupi i Punes ALBEITI me 4

maj 2011, si dhe e kemi perditësuar raportin mbi bzen e informacionit te marre deri me 3 gusht 2011.

Ne baze te keshilles se Sekretarit te Komitetit te Validimit, z. Sam Bartlett, ne e kemi bere validimin ne perputhje me rregullat EITI, duke perفشire udhezuesin e Validimit, Versioni i 24 shkurtit 2010.

Raporti perfshin:

- Nje permbledhje te procesit te Validimit te EITI, nje pasqyre mbi industrine nxjerrese te Shqiperise dhe nje permbledhje te EITI
- Nje perskrim te Planit te Punes EITI te Shqiperise dhe te progresit perkundrejt objektiveve te ketij Plani
- Nje vleresim te shkruar te progresit perkundrejt dhe ne perputhje me secilin tregues of the Grides(Listes) se Validimit
- Grida e plotësuar e Validimit, me vleresimin tone te perputhjes se Shqiperise me secilin Tregues
- Perfundimi dhe rekomandimet tona lidhur me zbatimin e EITI ne Shqiperi.

Shtojca e Raportit permban Listen e Atyre qe u pergjigjen. Pyetesoret e marre te Vetevleresimit te kompanise perfshihen ne vellimin 2(te atashuar veças).

1.2 Procesi i Validimit te EITI

Validimi(vlefshmeria) eshte procesi i vendosur nga Bordi i EITI per te percaktuar perputhshmerine me Parimet dhe kriteret e EITI te vendeve kandidate dhe te atyre qe aplikojne.

Validimi i Shqiperise EITI konsiston ne:

- perzgjedhjen e nje Validatori(Vleresuesi)
- pergatitjen
- nje vizite ne vend, e cila te çon ne prodhimin e nje raporti
- konsiderimin e nje raporti validimi(vlefshmerie) nga Grupi i Punes i ALBEITI dhe aprovimi i ketij raporti

- dorezimin e raportit te Validatorit(Vleresuesit) Sekretariatit Nderkombetar te EITI, marrja parasysh e ndonje komenti te bere nga Komiteti i Validimit dhe perfshirja e tij ashtu si duhet ne raport, si dhe livrimi i raportin Bordit te EITI per nje vendim
- publikimi i raportit final.

Qellimi kryesor i vizites ne vend eshte te aftesohet Validatori te kryeje nje vleresim bazuar mbi intervistat dhe diskutimet me veprimtaret baze(stakeholders), lidhur me progresin e bere ne zbatimin e EITI, s dhe te beje rekomandime per permiresime dhe te siguroje vijimesine e EITI ne vend.

Vendimi final lidhur me statusin e nje vendi i takon Bordit te EITI.

1.3 Perafrimi i Validimit dhe Aktivitetet

Ekipi i Validimit perbehej nga Dimitry Pozhidaev dhe David Quinn, me ndihme lokale te dhene nga Grupi VeVe, nen drejtimin e pergjithshem te Chris Nurse.

Perafrimi dhe metodologjia per Validimin jane percaktuar ne Udhezuesin e Validimit, te publikuar nga EITI, dhe bazohen ne:

- nje rishikim te dokumentacionit
- takime me anetare te Grupit te Punes ALBEITI dhe me perfaqesuesit e veprimtareve te tjere kryesore(stakeholders)
- qarkullimin e pyetesoreve me vetedeklarim te kompanive nxjerrrese qe veprojne ne Shqiperi.

Nje liste me te gjithë personat me te cilet ne u takuam gjate detyres, eshte perfshire ne Shtojcen 1 te ketij raporti.

Ne e vizituam Shqiperine nga data 17 deri ne daten 23 prill 2011 dhe qendruam ne Tirane.

1.4 Industrite nxjerrrese ne Shqiperi

1.4.1. Histori e shkurter e industrise nxjerrrese ne Shqiperi

Shqipëria ka shumë burime minerare, sidomos krom, baker, hekur-nikel dhe qymyr, si dhe naftë. Ajo ka në gjirin e saj një nga zonat tokësore naftembajtëse më të mëdha në Evropë: zona e Patos-Marinzes, për të cilën një numër i rritur i kompanive ndërkombëtare të naftës po sigurojnë licencat e kërkimit të naftës.

Megjithatë, sektori nxjerrës në Shqipëri ka patur si periudha aktiviteti të konsiderueshëm, ashtu dhe të një rënie të fortë të prodhimit. Për 50 vite, ky sektor ishte një burim thelbësor i rritjes industriale të vendit. Deri në vitet 80-të të shekullit të kaluar, Shqipëria ishte një nga prodhuesit më të mëdhenj të kromit në botë, si dhe të nikelit, hekurit dhe mineralizimit të bakrit. Pas një periudhe prej 3 dekadash rritjeje, prodhimi dhe eksportet minerare kapen një majë në vitin 1989 në 140 milionë dollarë amerikanë, ku kromi, bakri dhe nikelit përbenin rreth 80 përqind të eksporteve shqiptare sipas vlerës (Raport i Bankes Botërore, 2009). Gjatë kësaj kohe, industria nxjerrëse shqiptare nga vetëm ndërmarrje shtetërore, të cilat panë tej-rritjen e prodhimit nxjerrës, e cila ndoqi bumin e saj në fund të viteve 80-të të shekullit të kaluar. Nderkohe, prodhimi i naftës i Shqipërisë kapi majën e tij në vitin 1975, duke u ulur deri në vitin 1982, kur ndodhi një rënie më e shpejtë, për shkak të mungesës së fondeve për kërkim në fushë dhe për ekspertizë teknike.

Në vitin 1992, eksportet minerare ranë dukshëm në vetëm rreth 20 milionë dollarë, një rezultat i kombinuar ky i paqëndrueshmerisë politike, i rënies së brendshme ekonomike dhe i uljes së çmimeve globale të mallrave perkatese. Rënia e metejshme e sektorit nxjerrës ishte kaq e gjere, sa ato shfrytëzime të ngelura nga ajo kohe sot përdorin rreth 10 përqind të kapaciteteve prodhuese të vlerësuar, të degjeneruara pas vitesh mungese investimi (Raport i Bankes Botërore, 2009). Në mënyrë të ngjashme, Shqipëria ishte një eksportuese neto e produkteve të naftës deri në vitin 1989, mirepo në vitin 2001 vendi importonte 73 përqind të asaj që konsumonte.

Grafiku në vijim e ilustron këtë rënie, duke dhënë shifrat për prodhimin e kromit gjatë dy dekadave të fundit.

(vijon grafiku, që nuk mund të kopjohet nga versioni PDF-shen i perkth).

Vitet 90-të të shekullit të kaluar panë një ristrukturim gradual drejt privatizimit, me qeverinë që bente përpjekje domethënëse për të tërhequr kapitalin dhe teknologjinë e huaj, pas kolapsit të sistemit ekonomik komunist. Zbatimi i Ligjit Minerar të vitit 1994 katalizoi një levizje drejt një ambienti rregullator më të privatizuar dhe efikas, megjithatë transferimi i veprimeve (prodhimit) minerare tek investuesit çësorë nuk ndodhi në masën e parashikuar. Në vitin 1998, qeveria ndërmori një proces transferimi të licencës, për t'ju kaluar të drejtat e zbulimit dhe shfrytëzimit minerar individëve, mirepo ky proces deshtoi t'ua transferonte të drejtat atyre me ekspertizë dhe burimet e nevojshme për të nxitur një rimekëmbje në industrinë nxjerrëse.

Megjithate, gjate dekadës së fundit, vendi u ka dhënë licenca shpimi një numri kompanish amerikane, austriake, kanadeze, kroate, greke dhe suedeze, si dhe një numër në rritje të kompanive ndërkombëtare janë duke synuar licenca kërkimi. Kjo është përputhur me një fuqi punëtore në rritje dhe një fuqisë investimesh në sektorët e naftës, minierave dhe gazit, gjë e cila sjell optimizim për një rimekëmbje afatgjatë në industrinë nxjerrëse.

1.4.2. Profili i sotëm i sektorit nxjerrës

1.4.2.1 Minierat

Në vitin 2007, prodhimi industrial përbente rreth 8 përqind të Prodhimit të Brendshëm Bruto (GDP-se) të Shqipërisë (sipas Vjetarit 2008 të Mineraleve, një studim gjeologjik amerikan, shkurt 2010). Brenda këtij prodhimi, industria nxjerrëse përbente rreth 16 përqind të vlerës së prodhimit industrial (INSTAT 2008; FMN 2009). Që nga ajo kohë, ka patur shenja rritjeje në sektorin minierar të Shqipërisë (Banka Botërore, Raporti Nr. 47539-AI, "Reforma e sektorit të minierave të Shqipërisë, ristrukturimi dhe planet e ardhshme"-2009):

- Investimi në minierat e shkallës së vogël u rrit në 2.7 miliardë Lek në vitin 2008, nga 650 milionë Leke në vitin 2005.
- Fuqia punëtore u shtua nga 1800 vete në vitin 2005, në 6.000 vete në 2008.
- Prodhimi mbi baza vjetore u rrit dhe tani po shkon në nivelet e viteve 90-te, me rreth 3.5-4 milionë ton minerare në vit.
- Investimi për minierat e shkallës së gjere të kromit, bakrit dhe hekur-nikelit, si dhe të prodhimit të çimentos shkon në rreth 1 miliardë euro.

Prodhimi minierar në Shqipëri mund të ndahet si më poshtë (Statistika të publikuara nga METE, viti 2005):

- Materiale ndërtimi 47.4 përqind
- Zhavorr 37.9 përqind
- Krom 7.1 përqind (40 përqind të vlerës së prodhimit minierar)
- Qymyr 2.4 përqind
- Hekur-Nikel 4.7 përqind

- Gure dekorative 0.5 perqind
- Baker

Prodhimi i mineraleve kryesore ne Shqiperi(nga viti 2005-2008) eshte si me poshte(te dhena nga Studimi Gjeologjik amerikan, viti 2010):

Tabela 1. Prodhimi minerar ne Shqiperi: 2005-2008

Minerali	Njesia	Prodhimi			
		2005	2006	2007	2008
Krom	ton	162 771	212 581	199 771	207 104
Baker	ton	68 312	35 071	98 000	105 000
Hekur-Nikel dhe Nikel-Silikat	ton	800	79 000	369 559	353 290
Qymyr	ton	2 640	3 800	4 000	1 500
Bitum+ Rere bituminoze	ton	13 955	9 000	6 785	23 968
Gur Gelqeror	m3	1,337 373	1 339 440	1 716 122	3 837 529
Pllaka Guri Gelqeror	m3	-	23 193	29 263	27 900
Gur Gelqeror prej Mermeri	m3	-	11 620	2 805	4 264
Rere silici	m3	3 200	3 200	4 400	12 077
Argjile	ton	315 085	562 469	855 675	724 282
Gips	ton	14 770	19 683	46 200	77 633

Burimi: Agjensia Kombetare e Burimeve Natyrore, Shqiperi, 2010

1.4.2.2 Profile te mineraleve kryesore

Minerali i Kromit

Rezerva te provuara: 36.9 milion ton

Tre krahinat kryesore ku ndodhet kromi:

1. Rajoni i verilindjes: Tropoje dhe Kukes, masive ultrabazike
2. Rajoni qendror: masivi ultrabazik i Bulqizes
3. Rajoni juglindor: Shebenik-Pogradec, masiv ultrabazik

Bakri

Rezervat e provuara vleresohen ne rreth 53 milion ton me 1.3-2.5 Cu, por sot nuk ka prodhim. Format kryesore te bakrit te gjetura ne gjithe Shqiperine perfshijne:

- Depozita hidrotermale-metasomatike dhe sedimente vullkanogjene, te tilla si Munella, Qafe-Bari.
- Depozita me sedimente vullkanogjene, te tilla si Tuç, Spaç, Derven.
- Depozita sulfide metasomatike, te tilla si Kurbnesh, Golaj, Thirra.

Hekur-Nikeli

Nikeli shqiptar ndodhet ne tre rajone kryesore:

1. Devoll(Bilisht, Bitincke, etj.)
2. Pogradec-Librazhd(Guri i Kuq, Çervenaka, etj.), (Prrenjasi, Skroska, Xixillasi, Bushtrica)
3. Kukes(Mamez, Trull Suroj, Nome)

Qymyri

Rezervat shqiptare te qymyrit vleresohen ne rreth 794 milion ton dhe perqendrohen ne zonat e meposhtme:

- Tirane-rreth 86 perqind e rezervave
- Korçe-Pogradec-10 perqind te rezervave
- Memaliaj -4 perqind te rezervave.

1.4.2.2 Nafta dhe gazi

Pervec mineraleve, Shqiperia gjithashtu ka nafte dhe gaz natyror te konsiderueshem. Qeveria eshte tani duke nxitur prodhim te rritur per firmat nderkombetare te naftes dhe gazit, ne nisje te programit te saj te privatizimit. Kjo rritet edhe nga infrastruktura e zhvilluar petroliere e Shqiperise, me tre rafineri tregtare, si dhe lehtesira moderne portuale, te ndodhura ne detin Adriatik. Ka po ashtu nje sistem rrugor te zhvilluar mire, qe lehteson aksesin ne zonat e shpimit, si dhe infrastruktura e gazit po zgjerohet tashme. Megjithate, edhe pse ka pasur vityet e fundit interes te konsiderueshem ne sigurimin licenca te kerkimit te naftes, ende gazi natyror nuk eshte eksportuar.

Qeveria shqiptare ka shprehur interes ne bashkepunimin me kompanite e huaja per zbulimin dhe zhvillimin e hidrokarbureve ne te gjithe territorin e Shqiperise. Kjo ka rezultuar ne disa zbulime premtuese, per shembull, ne vitin 2008, kompania me baze ne Zvicer Manas petroleum(MNAP) deklaroi se kishte zbuluar 3 miliarde fuçi nafte dhe tre mije miliarde metra kub gaz natyror ne thellesi.

Nga viti 1991 e deri tani, kontratat jane nenshkruar dhe kompanite e meposhtme kane qene pershire ne kerkimin per shfrytezimin e naftes dhe te gazit(“Ptenciali i Hidrokarbureve”, Agjensia Kombetare e Burimeve Natyrore(2010).

Nafta ne det(offshore):

Deminex, OMV, Agip, Edison gas, Occidental, Chevron, BHP Petroleum, Svenska Petroleum Exploration, Premier Consolidated Oilfields, Capricorn Albania Limited, Island International Exploration, Beach Petroleum.

Nafta ne toke(onsshore):

Shell, Ina Naftaplin, Coparex, Lundin Petroleum, Premier Consolidated Oilfields, Enterprise, Clyde Expor PLC, MOL, Hellenic Petroleum, Anschutz, IPC, DWM Petroleum AG.

Tani i gjithe prodhimi shqiptar konsumohet ne tregun lokal, ose dergohet ne Itali, 50 km me ne perendim. Perveç tregjeve lokale, Shqiperia ndodhet ne udhekryq te shume projekteve te medha te tubacioneve te gazit nga rajoni i Detit te Zi per ne Evropen Perendimore.

Tabela 2. *Fushat Naftembajtese ne Shqiperi*

<i>Fusha</i>	<i>Viti i zbulimit</i>	<i>Thellesia e Rezervuarit(m)</i>	<i>Graviteti O/G(API)</i>
Drashovica	1918	100-200	Nafte<10o
Patos	1927	ne siperfaqe deri ne 1200	Nafte(12-24oAPI)
Kuçova	1928	ne siperfaqe deri ne 1500	Nafte(13-16oAPI)

Marinza	1957	1200-1800	Nafte(12-35oAPI)
Visoka	1963	800-1000	Nafte(5-16oAPI)
Gorisht-Kocul	1965	1000-2500	Nafte(17oAPI)
Ballsh-Hekal	1966	1000-3000	Nafte(12-24oAPI)
Cakran-Mollaj	1977	3000-4500	Nafte(14-37oAPI)
Finiq-Krane	1973	800-2000	Nafte(<10oAPI)
Delvina	1989	2800-3400	Nafte(31oAPI)
Divjaka	1963	2400-3000	Gaz&kondensuar
Ballaj-Kryevidh	1983	300-1700	Gaz
Frakulla	1965	300-2500	Gaz
Povelca	1987	1800-3500	Gaz&kondensuar
Panaja	1988	2500	Gaz
Ad-4(ne det)	1994	2500-3100	Gaz biogjenik
Sqepuri	2001	4950	Nafte(37oAPI)

Burimi: “Potenciali i Hidrokarbureve”, Agjensia Kombetare e Burimeve Natyrore, Shqiperi, 2010

Nafta Bruto:

Prodhimi i naftes krudo vleresohet te jete rritur te rreth 3,970.000 fuçi ne vitin 2008-nje rritje me 25 perqind ne krahasim me vitin 2007.

Kjo rritje eshte teresisht rezultat i shtimit te prodhimit nga kompania Bankers Petroleum Shpk. Kjo kompani e rriti prodhimin e naftes bruto ne fushen e saj Patos Marinza ne nje mesatare 5.875 fuçi ne dite, nga 4.724 fuçi ne dite ne 2007-en. Nga fundi i vitit 2008, Bankers Petroleum prodhonte deri ne 6960 fuçi nafte ne dite nga fusha e Patos Marinzes dhe e rriti sasine e rezervave te provuara ose te mundshme me 22 perqind, ne 180 milione fuçi nafte.

Nderkohe, kompania shtetere Albpetrol raportonte nje prodhim 281.147 ton ose 1.9 milione fuçi nafte bruto ne vitin 2008, te njejten sasi qe raportoi ne vitin 2007.

Nafta e rafinuar:

Ne shkurt 2008, qeveria shqiptare deklaroi qe kompania e vetme shtetere e Shqiperise e rafinimit dhe tregtimit te naftes ARMO do te privatizohet.

Ne qershor, qeveria deklaroi se nje konsorcium i perbere nga kompania e bazuar ne Zvicer Anica Enterprises dhe Mercuria Energy Group Shpk., si dhe kompania e bazuar ne SHBA Refinery Associates of Texas Inc. u perzgjodh si fitues i tenderit per 85 perqind te aksioneve te ARMO.

Konsorciumi ofroi 193.4 milion dollare dhe planifikonte te investonte rreth 354 milion dollare ne rafinerite e ARMO, te ndodhura ne Ballsh dhe Fier. Marreveshja u finalizua ne fillim te dhjetorit 2008 dhe konsorciumi i pagoi qeverise parate per blerjen e rafinerise(Ekonomia Shqiptare 2008, Koleka 2009, permendur ne Vrojtimi Gjeologjik Amerikan 2010.

Statistikat shqiptare te Naftes:

- Prodhimi i naftes: 6.425 fuçi ne dite (vleresim i 2007-es)
- Konsumi i naftes: 30.900 fuçi ne dite (vleresim i 2006-es)
- Eksporti i naftes: 748.9 fuçi ne dite (vleresim i 2005-es)
- Importi i naftes: 24.860 fuçi ne dite (vleresim i 2005-es)
- Rezervat e naftes: 199.1 milion fuçi (vleresim i 1 janarit 2008)

Statistikat shqiptare te Gazit Natyror:

- Prodhimi i gazit natyror: 30 milion m³(vleresim i 2006-es)
- Konsumi i gazit natyror: 30 milion m³(vleresim i 2006-es)
- Eksporti i gazit natyror: 0 m³(vleresim i 2007-es)
- Importi i gazit natyror: 0 m³(vleresim i 2007-es)
- Rezervat e gazit natyror: 849.5 milion m³(vleresim i 1 janarit 2008) (Te gjitha te dhenat e mesiperme jane marre nga website i Dhomes Shqiptaro-Britanike te Tregtise)

Ne teresi, prodhimi i gazit natyror ne vitin 2008 u rrit me 20 perqind, i naftes bruto me rreth 25 perqind, ndersa prodhimi i produkteve te rafinuara te naftes ra me 14 perqind, krahasuar me prodhimin e vitit 2007.

1.4.3. Mjedisi rregullator

1.4.3.1 Ligjet Minerare

Deri kohet e fundit, aktivitetet minerare ne Shqiperi rregulloheshin nga Ligji Minerar Nr. 7796 i 17 shkurt 1994, i cili ishte amenduar ne vitin 2001 dhe 2006. Megjithate, ne korrik 2010 ky ligj u abrogua nga ligji Nr. 10304 “Mbi Sektorin Minerar ne Shqiperi”.

Karakteristikat e Ligjit Minerar:

- Shqiperia mban pronesine mbi mineralet e ngurta dhe u jep te drejta te revokueshme (te heqshme) paleve te treta t’i zhvillojne keto burime.
- Me keto te drejta, investuesit jane te detyruar te investojne ne pronesine minerare, te jene ne perputhje me te gjitha nenet e ligjit, si dhe te japin raportime periodike vleresimi, duke verifikuar zbulimin ose zhvillimin e vazhdueshem ne menyre qe asetet minerar te permiresohet.
- Aktivitetet minerare mund te zhvillohen ne formen (i) e kerkimit-zbulimit, (ii) shfrytezimit dhe kerkim-zbulim-shfrytezimit (nje kombinim).
- Pagesat ndaj shtetit per privilegjin e zhvillimit te burimeve minerare perfshijne pagesat e rentes minerare- nje pagese e vetme qe kompania zhvilluese i ben qeverise mbi bazen e njesise se prodhimit, te ardhurave bruto, ose vleres se produkteve minerare te perpunuara.
- Entet ligjore (kompanite) dhe individet kane te drejte te zhvillojne aktivite minerare, por duhet qe fillimisht te marrin leje minerare, sipas kategorise minerare specifike. Entet duhet t’i paraqesin nje kerkese Qendres Kombetare te rregjistrimit, sipas procedures se parashikuar ne nenet 17, 31, 32 dhe 33 te ligjit “Mbi Liçencat, Autorizimet dhe Lejet ne Republiken e Shqiperise”.
- Sipas Ligjit Minerar te vitit 2010, u fut nje sistem i ri klasifikimi i rezervave minerare, i cili konsiston ne: a) rezerva metalike, jo-metalike, qymyr dhe minerale bituminoze, b) materiale ndertimi, c) minerale te çmueshme dhe gjysem te çmueshme dhe d) minerale radioaktive.

Ligje te tjera qe lidhen me sektorin minerar perfshijne:

- Ligjin “Mbi Liçencat, Autorizimet dhe Lejet ne Republiken e Shqiperise” Nr. 10081 date 23.02.2009
- Udhezimi Nr. 1028 date 10.12.2009 “Mbi permbajtjen e dokumentacionit per dhenien e nje leje minerare”, nga Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes
- Ligjin “Mbi perdorimin civil te eksploziveve ne Republiken e Shqiperise” Nr. 9126 date 29.07.2003

- Ligjin “Mbi Koncesionet” Nr. 9663 date 18.12.2006
- Ligjin “Mbi Taksat Kombetare” Nr. 9975 date 28.07.2008

1.4.3.2 Ligjet e Naftes

Zbulimi, zhvillimi dhe prodhimi i naftes ne Shqiperi qeveriset nga Ligji i Naftes (Zbulim dhe prodhim” Nr. 7746 date 28 korrik 1993 dhe nga legjislacioni shqiptar dhe aktet nenligjore per zbulimin dhe prodhimin e naftes.

Ky Ligj eshte amenduar me:

- Ligjin Nr. 7853 date 29 korrik 1994
- Ligjin Nr. 7811 date 12 prill 1994 “Mbi Miratimin e Dekretit Nr. 782 date 22.02.1994 “Mbi Sistemin Fiskal ne Sektorin e Hidrokarbureve(Zbulim dhe prodhim)”
- Ligjin Nr. 9975 date 28.07.2008 “Mbi Taksat Kombetare”.

Ky kuader ligjor i amenduar eshte ndertuar qe t’i jape fleksibilitet qeverise ne negocimin e kushteve te pranueshme me kompanite e naftes, me qellim te nxitjes se zbulimit te naftes shqiptare.

Ligji i Naftes thote se te gjitha depozitat e naftes qe ndodhen ne gjendjen e tyre natyrore ne zona brenda juridiksionit te Shqiperise jane prone eskuzive e Shtetit shqiptar. Ligji i naftes i lejon shprehimisht Ministrise se Industrise dhe Energjise(sot METE-shen i perkth) qe te hyje ne nje Marreveshje Naftes, sipas se ciles nje kompanie naftes mund t’i jepen te drejta eskuzive per te zbuluar dhe per te prodhuar naftes.

Objektivi i deklaruar i qeverise eshte te negocioje kushte me industrine e naftes, te cilat te jene te drejta dhe te balancuara, duke patur parasysh rrezikun e zakonshem qe lidhet me zbulimin dhe pronesine shteterore mbi burimet natyrore. Per me teper, qeveria shqiptare synon te inkurajoje zhvillimin e aktiviteteve zbuluese te vogla dhe ne zona te largeta, nepermjet kuadrit te saj fiskal.

Per kete qellim, METE, nepermjet Agjensise Kombetare te Burimeve Natyrore ka deklaruar zonat e lira te naftes ne toke dhe ne det, te hapura per kerkim dhe zhvillim te naftes, si dhe nxit aplikime per Marreveshje te Ndarjes se Prodhimit(“Potenciali i Hidrokarbureve”, Agjensia Kombetare e Burimeve Natyrore, Shqiperi, 2010).

1.4.3.3 Taksimi dhe Rregullimi(kuadri rregullator)

Qe nga 1 janari 2008, Shqiperia zbaton sistemin e takses se sheshte 10 perqind(duke perjashtuar TVSH-ne, Tatimin mbi Vleren e Shtuar). Kontributet e sigurimeve shoqerore per bizneset po ashtu taksohen 10 perqind. Eshte menduar me kete sistem qe qeveria te zgjeroje bazen e taksapaguesve dhe te thjeshtoje administraten fiskale, duke e kthyer Shqiperine ne nje vend te lehte per te investuar.

Tabela 3. Sistemi i Taksave shqiptare dhe nivelet

<i>Sistemi i takses</i>	<i>Niveli i takses</i>
Taksa mbi Fitimin	10%
Taksa mbi te Ardhuren Personale	10%
Taksa ne Burim	10%
Taksa mbi Vleren e Shtuar	20%
Taksa mbi Pronen e Paluajtshme	Niveli i takses per ndertesat eshte mes 5-200 Leke/m2/ne vit, sipas tipit te nderteses dhe zones ku ajo ndodhet. Niveli i takses per token bujqesore eshte mes 700-5600 Leke/ha/ne vit, sipas kategorise se tokes dhe rrethit ku ajo ndodhet.
Akcisa	75% per nenproduktet e naftes(por jo me shume se 37 Leke per liter dhe jo me pak se 27 Leke per liter)
Niveli i Takses mbi Fitimin	10%
Niveli i Takses mbi Fitimet e Kapitalit	10%
Niveli i Takses se Zyres se Deges(Filialit)	10%
Taksa mbi Dividendin	10%
Taksa mbi Interesin	10%
Pagesa te Rentes nga patentat, etj	10%
Taksa mbi te Ardhuren Korporative	Te gjitha kompanite(vendase dhe te huaja) qe jane te rregjistruara per TVSH jane subjekte te nivelit te Takses mbi Fitimin, e cila qe nga 1 janari 2008 u ul nga 20 perqind ne 10 perqind. Taksapaguesit rezidente taksohen vetem per te ardhurat e tyre nga burimi shqiptar.

Taksa minerare specifike:

- Taksimi mbi minierat qeveriset nga i njeiti sistem taksash qe perdoret per çdo aktivitet tjeter ne Shqiperi.

- E vetmja takse qe eshte speciale per aktivitetin minerar eshte **pagesa e rentes minerare prej 2 perqind mbi shitjet**.
- Nuk ka kufizime mbi pronesine e huaj ose kufizime mbi kapitalin/dividendin.
- Ka nje rregjim te lire nga taksat doganore(duty-free), per importimin e pajisjeve te minierave.

1.4.3.4 Lejet Minerare

Privatizimi i burimeve minerare shqiptare shoqerohet me dhenien e lejeve te kerkimit, te koncesioneve te zbulimit dhe te koncesioneve minerare per kompani shqiptare dhe te huaja. Secili individ apo kompani(vendas apo i huaj) mund te ushtroje aktivitet minerar, pasi te kete marre nje Leje minerare, te leshuar nga METE(Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes).

Leja minerare ben dallim te se drejtes se paprekshme dhe te pavarur prej se drejtes se pronarit te tokes(Shtetit). Ka tre tipe lejesh minerare:

1. Leje per qellime kerkimi
2. Leje per zbulim/eksplorim
3. Leje per shfrytezim.

Tarifat e meposhtme aplikohen mbi individet dhe kompanite vendase apo te huaja, te cilat marrin nje license apo leje profesionale:

- individet: 6.000 Leke per çdo vit te vlefshmerise se licences
- Aksesore(pjese ndihmuese) te licences per individe: 4.000 Leke
- Rinovimi per individet: 6.000 Leke
- Konvertimi i licences: 15.000 Leke
- Kompanite: 60.000 Leke.

Deri ne dhjetor 2009 ishin dhene 832 leje minerare, prej te cilave 680 ishin leje shfrytezimi. Totali i 832 lejeve minerare ndahet ne("Burimet Minerare ne Shqiperi", Agjensia Kombetare e Burimeve Natyrore, Shqiperi, 2010).:

- 262 leje per krom

- 37 leje per hekur-nikel dhe nikel-silikat
- 282 leje per gur gelqeror
- 15 leje per gur gelqeror prej mermeri
- 18 leje per baker
- 5 leje per qymyrguri
- 2 leje per boksite
- 5 leje per kuarc
- 11 leje per gips alabaster
- 35 leje per argjile
- 35 leje per tulla prej guri gelqeror
- 26 leje per gur ranor
- 2 leje per plagjogranite.

Liçencat e shfrytezimit te mbetura perfshijne gure, te tille si gure gelqerore te thyer, rera kuarci, gure ranore, shiste, rera bituminoze dhe zhavorr, bazalte dhe shkembinj ultrabazike.

1.4.3.4 Marreveshjet e naftes

Marreveshjet e naftes mes Shtetit dhe kompanive te naftes marrin formen e Marreveshjeve te Ndarjes se Prodhimit, te nenshkuara mes METE, te perfaqesuar nga Agjensia per Burimet Natyrore dhe Kontraktorit, ne perputhje me Ligjin e Naftes te vitit 1993.

Ne rastin e nje zbulimi tregtar, periudha per zhvillimin dhe prodhimin ne zonen e zhvillimit do te jete 25 vjet dhe mund te shtyhet edhe me shume, ne perputhje me percaktimet ne Ligj.

Gjendja e liçencave te dhena per zbulimin e naftes ne Shqiperi, deri ne 1 shkurt 2008, ishte si me poshte (Agjensia Kombetare e Burimeve Natyrore, website i saj i aksesuar me 15 prill 2011):

- Blloku i Durrësit (ne det), i dhene ne vitin 2004. Kontraktor dhe operator eshte Island International Exploration BV dhe Beach Petroleum

- Blloku Joni 5(ne det), i dhene ne 2007. Kontraktor dhe operator eshte Capricorn Albania Shpk.
- Blloqet A dhe B(ne toke), te dhena ne 2007. Kontraktor dhe operator eshte DWM Petroleum AG.
- Blloqet D dhe E(ne toke), te dhena ne 2007. Kontraktor dhe operator eshte DWM Petroleum AG.

Pervec ketyre blloqeve te dhena, negociatat per Bllokun e Rodonit te Veriut(ne det) dhe per blloqet 2 dhe 3 ne toke kane arritur fazen e tyre finale. Agjensia Kombetare per Burimet Natyrore ka nxjerre licenca dhe nenshkruar marreveshje me Albpetrolin(kompania kombetare e naftes) per zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve ne nje sere fushash.

1.4.4. Kompanite qe veprojne ne sektorin nxjerrës të Shqipërisë

1.4.4.1 Kompanite Minerare

<i>Kompania</i>	<i>Sektori</i>	<i>Pronesia</i>	<i>Profili</i>
Albanian Chrome (ACR)	Prodhimi i kromit dhe i bakrit	DCM Decomental	Albanian Chrome(ACR) eshte emri i ri i kompanise DARFO Albania, kompanise me te madhe te prodhimit te kromit ne vend, se ciles qeveria shqiptare i dha nje kontrate koncesionare ne vitin 2001, per te rizevilluar pothuajse 50 perqind te fabrikave ekzistuese te industrise se kromit. Ne qershor 2009, ACR nisi nje projekt me vlere 30 milione euro(41.3 milione dollare), duke synuar rritjen e konsiderueshme te prodhimit ne minieren e saj kryesore te ferrokromit ne Bulqize
Alfa Nikel	Prodhim Nikeli	S'ka te dhena	Kohet e fundit Alfa Nikel nenshkroi nje marreveshje koncesioni me qeverine shqiptare, per te perdorur zonen minerare ne Bilisht, rrethin e Korçes ne juglindje te Shqipërisë. Zona e bilishtit ka nje kapacitet prodhimi prej 200.000 tonesh ne vit.
Empire Mining	Prodhim Kromi	S'ka te dhena	Korporata Empire Mining ka marre te drejtat eskuzive te zbulimit dhe zhvillimit per kater licenca zbulimi, qe perbejne ne total nje

			siperfaqe prej 64.5 km ² , brenda Masivit Ultramasik krom-mbajtes te Bulqizes, qe ka qene historikisht prodhues.
JAP Resources	Zbulim/Prodhim kromi, ari dhe bakri	100% filial i Golden Touch Resources Corporation	JAB(Australia) u formua ne vitin 2006 dhe ka qene aktive ne Shqiperi qe nga viti 2007. Ajo tani mban 5 leje eskuzive zbulimi per: Rubikun, Livadhezen, Kalimashin, Zogajn dhe Bregun e Bibes-qe mbulojne te gjitha 239 km ² .
BerAlb	Zbulim/Prodhim Bakri	S'ka te dhena	BERAlb tani mban licencat per minierat e bakrit te Munelles, Lak Roshit dhe Karmas. Ai gjithashtu ka vene ne pune fabriken e Koncentratit te Bakrit ne Fushe-Arrez dhe fabrikat ne rrethin e Pukes. Kjo fabrike eshte zgjeruar kohet e fundit dhe po synohet te kete nje kapacitet perpunimi te mineralit te bakrit prej 600.000 ton ne vit.
Tires Resources	Zbulim bakri, zinku, ari dhe argjendi	S'ka te dhena	Tirex Resources Shpk. u formua per te kryer aktivite zbulimi dhe zhvillimi minerali ne Shqiperi. Tirez ka marre 553 km ² te nje zone ne Mirdite qe mbulon pjesen me te madhe te ketij rrethi tradicional minerar. Tani po perqendron perpjekjet e veta drejt zhvillimit te potencialit te projektit Mirdita ne nje rreth me Masiv Vullkanogjenik Sulfid, me depozita te shumefishta te gjera te mineralizimeve te bakrit, zinkut, arit dhe argjendit.
Balkan Resources	Zbulim bakri dhe nikeli	Ndermarrje e perbashket	Kompanise Balkan Resources i jane dhene tre licenca zbulimi ne Shqiperine jugore: kokogllave, Verniku dhe Zemblaku. Ajo ka hyre ne ndermarrje te perbashket 50/50 me European Nickle, duke krijuar nje kompani te re "Devolli Resources Shpk", e cila po zbulon burimet e nikelit ne krahine e Devollit
European Nickel(ENK)	Zbulim nikeli	Ndermarrje e perbashket	ENK eshte nje ndermarrje e perbashket me kompanine Balkan Resources per te zhvilluar se bashku vendburimin e kompanise Balkan Resources, Kokogllave("Koko") dhe depozitat e nikelit ne krahine e Devollit. Depozitat ndodhen ne Shqiperine juglindore, prane kufirit me Greqine. Depozitat laterite te nikelit te Devollit kane nje permbajtje nikeli prej 427.000 ton(nga 35.6 milion ton

			me 1.20% nikel). EKN do te fitoje nje interes 50%, duke kontribuar ne depozitat e Devollit dhe duke i hapur akses, nepermjet nje marreveshjeje per licencen, teknologjise se saj te larte, njohjes dhe eksperiences.
G&N Albania Minerals Shpk.	Prodhim kromi dhe shitje me shumice minerali	S'ka te dhena	G&N Albanian Minerals Shpk. eshte nje shites me shumice mineralesh, i specializuar ne furnizimin me mineral kromi. Ajo ka kontrata eskluzive me pjesen me te madhe te minierave shqiptare. Ky eskluzivitet i lejon G&N te furnizoje deri ne 250.000 ton krom ne vit.
Albania Minerals and Bytyçi Shpk.	Prodhim kromi, zbulim minerali	Ndermarrje e perbashket	Kompania Albania Minerals eshte nje furnizuese kryesore me mineral kromi, boksite, baker, nikel, kuarc, magnezium dhe minerale te tjera. Ajo ka te drejtat e minieres se kromit ne Tropoje, ku ka rreth 100 milion+ton minerale te vleresuara. Ajo ka po ashtu raportime gjeologjike dhe te çpimeve per minerale te provuara kromi, bakri, alumini, magnezi, nikeli, kobalti dhe minerale te tjera.

1.4.4.2 Kompanite e Naftes

Kompania	Sektori	Pronesia	Profili
Albpetrol	Prodhim nafte dhe gazi	100% pronesi shteterore	Kompania e naftes me e madhe ne Shqiperi, me monopolin ne industrine e naftes dhe gazit deri ne vitin 1993, kohe kur kompanite e huaja u autorizuan te vepronin. Ne korrik 2010, u deklarua se Albpetrol do te fillonte te shiste naften e tij bruto ne menyre te lire ne treg. Ne tetor 2010, qeveria u ankua se menaxhimi i kompanise nuk ishte efikas dhe beri publike planet per te privatizuar Albpetrolin. Negociatat e tenderit per kete proces privatizimi jane aktualisht duke u

			kryer
Bankers Petroleum	Zbulim/Prodhim nafte dhe gazi	Nuk ka te dhena	Mban te drejta te plota per te zhvilluar fushat me nafte te rende te Patos-Marinzes dhe te Kuçoves, me marreveshje licencimi 25 vjeçare; ka arritur nje Marreveshje Nafte me Albpetrolin.
Stream Oil and Gas	Zbulim/Prodhim nafte dhe gazi	Nuk ka te dhena	Stream eshte aktualisht e perqendruar ne ri-aktivizimin dhe ri-zhvillimin e projekteve te tij prodhues ne Shqiperi: tre zona te naftes se rende ne toke: Cakran-Mollaj, Ballsh-Hekal dhe Gorisht-Kocul, si dhe te nje fushe prodhimi gazi ne toke, ne Delvine.
IEC Visoka	Zbulim nafte	Grupi IEC	Ka nje Marreveshje Nafte me Albpetrolin per te zhvilluar fushen e naftes se Visokes. Prodhimi mesatar nga fusha e naftes eshte 40ton/dite nafte te rende. Sipas Marreveshjes, Grupi IEC do te perdore nje metode te re per te intensifikuar procesin e nxjerrjes se naftes, nepermjet fluideve katalitike.
Sherwood International	Zbulim/Prodhim nafte	Bankers Petroleum 100% interes	Ne vitin 2008, Bankers Petroleum mori 50% te aksioneve te mbetura ne fushen e naftes ne Kuçove, te mbajtura nga Sherwood International.
Capricorn Albania	Prodhim nafte dhe gazi	Cairn Energy Plc: 100 % interes	Ka nje Marreveshje Nafte per naften ne det ne bllokut Joni 5.
Island International Exploration	Zbulim/Prodhim nafte dhe gazi	Ndermarrje e perbashket me Beach	Ne shkurt 2011, kompania Island International bleu 50% te aksioneve te bllokut Durresi te naftes dhe gazit ne det nga Lundin Albania BV. Ajo po ashtu ka hyre ne nje ndermarrje te perbashket me Beach Petroleum Ltd. per bllokun e Durresit. Blloku mbulon nje siperfaqe prej 4.200 km ² pergjate bregut te detit Adriatik dhe mban nje zbulim gazi te kondensuar ne thelesi te ujit, ende per t'u vleresuar, si dhe shume prospekte nafte dhe gazi te paçpuara.
Sky Petroleum	Zbulim/Prodhim nafte dhe gazi	Nuk ka te dhena	Sky Petroleum ka marre te drejta eskuzive per 3 blloqe zbulimi, ne total 5,000 km ² , duke perfaqesuar rreth 20% te mases tokesore te Shqiperise. Blloku Kater ndodhet ne juglindje te Shqiperise, ne kufi me Greqine; Blloku Pese ndodhet ne jugperendim te Shqiperise, prane detit

			Adriatik; Blloku i Dumrese ndodhet menjehere ne veri te fushes se naftes te Kuçoves.
Petromanas Energy Inc.	Zbulim nafte	Petromanas eshte blere 100% e Manas Adriatic GmbH prej DWM Petroleum, nje filial teresisht i zoteruar nga Manas Petroleum	Petromanas ka tre Kontrata me Ndarje Prodhimi me qeverine shqiptare. Sipas kushteve te PSC-ve, Petromanas nga 100% te aksioneve ne gjashte blloqe ne toke(Blloku A,B,D,E, 2 dhe 3), qe perfshijne me shume se 1.7 milion dynyme pergjate rrethit te Beratit.

2. Progresi perkundrejt Planit te Punes se vendit

Kryeministri nxorri nje Urdher(Nr. 156 date 27 dhjetor 2008), duke themeluar nje Grup Nderinstitucional Pune, te perbere nga perfaqesues prej institucionesh te ndryshme shteterore dhe nga perfaqesues te ftuar nga Drejtuesi i Grupit, nga organizata jofitimprurese, nga Banka e Shqiperise, nga Enti Rregullator i Energjise, nga grupe interesi dhe nga Bashkimi i Dhomave te Tregtise dhe Industrise.

Shqiperia aplikoi per statusin e vendit kandidat ne EITI ne mars 2009 me nje leter nga Ministri i Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes te dates 30 mars 2009.

Grupi i Punes e aprovoi Planin e Punes te vendit, te pergatitur me asistencen e Bankes Boterore, ne takimin e tij te pare me 17 mars 2009.

Plani mbulon periudhen nga 2009 deri ne 2011, duke perfshire Validimin. Plani eshte teresisht i kostuar(qe perfshin kostot) dhe permban burime te identifikuara te financimit(per me shume detaje, shih Treguesin 4).

Plani identifikon kater objektiva madhore qe lidhen me zbatimin e EITI ne Shqiperi. Objektivat lidhen ngushte me fazat kryesore te EITI dhe marrin parasysh treguesit e validimit te EITI. Keta objektiva jane deklaruar si me poshte:

- Objektivi 1: Siguro perkushtim per te zbatuar EITI dhe themelo nje grup pune EITI
- Objektivi 2: Pergatit, zhvillo dhe publiko nje plan pune EITI
- Objektivi 3: Hiq pengesat ndaj EITI/ndaj ndertimit te kapaciteteve dhe ndaj aksesit ne publik te EITI
- Objektivi 4: Ploteso dhe shpernda raportin EITI
- Objektivi 5: Validimi i zbatimit te EITI

Secili objektiv perfshin nje numer aktivitetesh madhore dhe aksionesh te lidhura me to. Progresi i arritur ne lidhje me secilin nga objektivat diskutohet me poshte.

2.1 Objektivi 1: Siguro perkushtim per te zbatuar EITI dhe themelo nje grup pune EITI

Objektivi perfshinte kater aktivitete:

- (a) deklarate publike pa ekuivoke(medyshje) te qellimit per te zbatuar EITI (shih Treguesin 1)
- (b) percaktimi i pikes se referimit/koordinatorit ne qeveri(shih Treguesin 3)
- (c) Qeveria perkushtohet per te punuar me te gjitha grupet e interesit dhe veprimtaret kryesore(p.sh. me shoqerine civile, me kompanite) ne lidhje me EITI(shih Treguesin 2)
- (d) themelim i nje Grupi Pune nderinstitucional EITI(shih Treguesin 5).

Dy aktivitetet e para jane kryer. Komentari ne lidhje me zbatimin e aktiviteve (c) dhe (d) permbahet respektivisht ne seksionet 3.2 dhe 3.5.

2.2 Objektiv 2: Pergatit, zhvillo dhe publiko nje plan pune EITI

Ky objektiv kishte aktivitetet e meposhtme:

- (a) pergatit, zhvillo dhe publiko nje plan pune EITI dhe nje skedul zbatimi;
- (b) identifikoj burime te qendrushme te financimit te zbatimit te EITI; dhe
- (c) themelo nje sekretariat lokal EITI.

Aktivite brenda ketij objektivi jane kryer gjeresisht, edhe pse disa prej tyre me vonese domethenese, sikurse do te shpjegohet me poshte.

Procesi i identifikimit te burimeve te qendrushme te zbatimit EITI ende eshte ne progres, mirepo ne jemi siguruar nga METE, e cila eshte agjensia qeveritare pergjegjese per zbatimin e EITI, se buxheti afatgjate i Ministrise per vitet 2011-2014 do te perfshije fonde mjaftueshem per Sekretariatin EITI dhe aktivitetet e tjera te lidhura me EITI.

Sipas planit te punes, Sekretariati lokal duhej te themelohej nga fundi i Prillit 2009. Ne realitet, Keshilli i Ministrave nxorri Vendimin Nr. 540 per themelimin dhe funksionimin e Sekretariatit te EITI ne 7 korrik 2010, mirepo Sekretariati nuk mundi te behej veprues vecse ne fund te 2010-es. Asnje shpjegim per kete vonese domethenese nuk na u prezantua.

2.3 Hiq pengesat ndaj EITI/ndaj ndertimit te kapaciteteve dhe ndaj aksesit ne publik te EITI

Ky objektiv ka percaktuar aktivitetet e meposhtme:

- (a) rishikimi i kuadrit ligjor per te identifikuar pengesat potenciale ndaj zbatimit te EITI;
- (b) ndertim kapacitetesh/trajnim per qeverine mbi EITI dhe ceshtjet e sektorit te naftes;
- (c) ndertim kapacitetesh/trajnim per shoqerine civile(duke perfshire median) mbi EITI dhe ceshtjet e sektorit te naftes;
- (d) ndertim kapacitetesh/trajnim per dhe nga industria mbi EITI dhe ceshtjet e sektorit te naftes;
- (e) aktivite te informimit te publikut, dhe

(f) ndertim kapacitetesh per te monitoruar te Ardhuren e Qendrueshme te Vleresuar(ESI).

Me perjashtim te aktivitetit te pare(rishikimi i kuadrit ligjor, per me shume detaje shih Treguesin 8), nuk eshte e mundur te besh ndonje gjykim perfundimtar nese pikat e tjera te planit jane zbatuar, perderisa plani i punes nuk jep ndonje target te matshem per keto aktivite.

Nje numer veprimesh jane kryer per te zbatuar aktivitetet e pikave (b) dhe (c)(per me shume detaji, shih treguesit 6 dhe 7), por eshte e pamundur te thuash nese keto veprime ne menyre kolektive barazohen me zbatimin e aktiviteve perkatese. METE sugjeroi qe perqindja e buxhetit te planifikuar te shpenzuar mund te perdorej si nje tregues arritjeje, por kjo eshte nje mase input-i, e cila nuk jep permase te kenaqshme te progresit ne terma te output-it apo impaktit.

Ne nuk mundem te gjenim ndonje evidence(prove) per zbatimin e aktivitetit (f), mirepo, sipas sqarimit te marre nga METE, ky aktivitet lidhet me ndertim kapacitetesh te brendshme brenda vete Ministrise dhe nuk eshte me rendesi per zbatimin e EITI. Nese eshte keshtu, eshte e paqarte perse ai eshte pare si nje “pengese ndaj EITI” ne Planin e Punes se vendit.

2.4 Objektiv 4: Ploteso dhe shpernda raportin EITI

Ky objektiv perbehet nga pese aktivite:

- (a) zhvillo nje format raportimi per raportin EITI;
- (b) percakto dhe bjer dakort me nivelin e bashkimit/dizagregimit(ç’bashkimit, shperberjes);
- (c) percakto termat e references dhe rekruto nje konsulent per te percaktuar nese procesi dhe synimi i pergatitjes se Raporti Vjetor te Fondit te Naftes eshte ne perputhje me formatin e raportimit;
- (d) raporti i rakordimit EITI i plotesuar nga konsulenti dhe i rene dakort(ose i hedhur poshte) nga grupi i Punes i EITI; dhe
- (e) publiko dhe shpernda raportin e rakordimit te pagesave EITI dhe ia kalo ate Qeverise.

Dy aktivite e para, (a) dhe (b) jane zbatuar, edhe pse disi me vone nga sa ishin planifikuar. Sipas planit te punes, formatet e raportimit duhej te pergatiteshin deri ne Qershor 2009. Megjithate, formati i raportimit, duke perfshire nivelin e bashkimit/dizagregimit, u paraqit ne mbledhjen e Grupit te Punes te dates 4 dhjetor 2009. Minutat(shenimet) e atij takimi nuk permenden diskutim te formatit dhe nuk eshte e qarte nese formati eshte miratuar zyrtarisht nga Grupi i Punes. Marrja ne pune e nje administratori te pavarur per raportin EITI po ashtu ndodhi shume me vone se sa ishte planifikuar fillimisht: sipas Planit te Punes, termat e references ishin

per t'u pergatitur dhe administratori i pavarur duhej te ishte rekrutuar deri ne Qershor 2009, ndersa ne realitet Grupi i Punes i diskutoi termat e references me 23 dhjetor 2010 dhe administratori i pavarur u perzgjodh nga Grupi i Punes me 14 shkurt 2011. Nuk u dha nje shpjegim i kenaqshem per kete vonese domethenese qe nga qershori 2009.

Aktiviteti (e) nuk eshte kryer. Grupi i Punes e aprovoi raportin nga administratori i pavarur me 4 maj 2011.

Sipas Planit te Punes, raporti i rakordimit te pagesave duhej te ishte publikuar dhe shperndare ne fund te Janarit 2011. Nuk eshte dhene shpjegim per kete vonese.

2.5 Objektiv 5: Validimi i zbatimit te EITI

Ky objektiv ka dy aktivitete te lidhura me te:

(a) Validimin e EITI, dhe

(b) Publikimin dhe shperndarjen e raporti te validimit te EITI.

Te dyja aktivitetet jane te vonuara: Validuesi duhej te ishte zgjedhur nga fillimi i vitit 2011, mirepo ftesa per te dhene propozime nuk doli deri me 7 janar 2011, me nje afat deri ne 28 janar 2011, per te marre aplikimet. Procesi i metejshem i prokurimit mori rreth dy muaj, perpara se sa nje kontrate te perfundohej. Validimi megjithate, duhej te ishte plotesuar nga fundi i marsit, me publikimin dhe shperndarjen e raportit te validimit, duke filluar rreth te njejtes kohe. Vonesa ne fillimin e caktimit te nje validuesi lidhet me lansimin e vonuar e aktiviteteve qe kane te bejne me raportin e rakordimit te pagesave EITI, sikurse u shpjegua ne paragrafin e meparshem.

Tabela me poshte permbledh progresin perkundrejt planit te punes. Tabela tregon progresin perkundrejt aktiviteteve dhe veprimeve, ashtu sikurse ato jane te formuluar ne planin e punes dhe nuk tregon qe treguesit e lidhur me te jane arritur.

Tabela: Progresi i Shqiperise perkundrejt planit te punes EITI

Aktivite te planifikuara	Progresi	Aktivite te planifikuara	Progresi
1. Siguro perkushtim per te zbatuar EITI dhe themelo nje grup pune EITI		3. Hiq pengesat ndaj EITI/ndaj ndertimit te kapaciteteve dhe ndaj aksesit ne publik	
1.a Deklarate publike pa ekuivoke(medyshje) te qellimit per te zbatuar EITI		3.a Rishikimi i kuadrit ligjor	
1.b Percaktimi i pikes se referimit/koordinatorit ne qeveri		3.b-d Ndertim kapacitetesh per qeverine/shoqerine civile/kompanite mbi EITI	Progresi nuk mundi te arrihet
1.c Qeveria perkushtohet per te punuar me te gjitha grupet e interesit dhe veprimtaret kryesore		3.e Aktivite te informimit te publikut	Progresi nuk mundi te arrihet
1.d Themelimi i nje Grupi Pune nderinstitucional EITI		3.f Ndertim kapacitetesh per te monitoruar te Ardhuren e Qendrueshme te Vleresuar	Progresi nuk mundi te arrihet
2. Pergatit, zhvillo dhe publiko nje plan pune EITI		4. Ploteso dhe shpernda raportin EITI	
2.a Pergatit, zhvillo dhe publiko nje plan pune EITI dhe nje skedul zbatimi		4.a-b Zhvillo nje format raportimi per raportin EITI dhe bjer dakort mbi nivelin e shperberjes	Plotesuar me vonese
2.b Identifiko burime te qendrueshme te financimit te zbatimit te EITI	Ne progres	4.c Percakto termat e references dhe rekruto nje administrator te pavarur	Plotesuar me vonese
2.c Themelo nje sekretariat lokal EITI	Plotesuar me vonese	4.d Ploteso dhe mirato raportin EITI	
		4.e Publiko dhe shpernda raportin EITI	
		5. Validimi i zbatimit te EITI	
		5.a Drejto validimin	Ne progres
		5.b Publikimi dhe shperndarja e raportit te Validimit EITI	

Plani është i kenaqshëm në atë që aktivitetet më të mëdha janë përcaktuar. Megjithatë, mungesa e targeteve të matur si duhet përkundër disa prej aktivitetëve të bën monitorimin e progresit të vështirë.

Megjithë pyetjet e perseritura, një rezultat që në intervistat nuk sollën ndonjë shpjegim për vonesat e përhershme dhe ekzistenca apo efikasiteti i proceseve të duhura të monitorimit është në pikepyetje.

2.6 Objektivi 6: Qëndrueshmëria dhe zbatimi në vijimesi i EITI

Pas një starti të mirë në vitin 2008 dhe në fillim të 2009-es, progresi i paketës është bërë deri në fund të 2010-es. Shumë është arritur në tre-katër muajt e parë të vitit 2011, por ka, sipas pikepamjes sone, evidence (prova) të pamjaftueshme për një zbatim të qëndrueshëm, për të qenë të aftë të konkludojmë mbi qëndrueshmërinë e ardhshme të EITI në Shqipëri.

3. Raport mbi Progresin përkundër treguesve të Grides (Listes) së Validimit

3.1 Treguesi 1 i Grides: A ka nxjerrë Qeveria një deklaratë publike pa ekuivoke për qëllimin e saj që ta zbatojë EITI-n?

Progresi deri tani

Kryeministri i Shqipërisë deklaroi se Shqipëria vendosi ta zbatojë EITI. Kjo u deklarua në një leter drejtuar Kryetarit të EITI, Peter Eigen me datë 16 janar 2009 dhe u rikonfirmua në Konferencën Globale të EITI në Doha, Katar në datat 16-17 shkurt 2009. Që atëherë, qeveria ka konfirmuar përkushtimin e saj ndaj zbatimit të EITI në mënyrë publike në shumë raste, duke përfshirë Konferencën e EITI në Paris, më 2-3 mars 2011.

Pikepamjet e veprimtareve kryesore

Te gjithë veprimtarët kryesorë të konsultuar pranojnë që ky tregues është arritur.

Vlerësimi i Validuesit

Ky tregues është arritur.

Natyra publike e deklarates se Qeverise ne plan nderkombetar nuk ngre asnje dyshim. Megjithate, ne do te vinim re se megjithe kerkesat tona te perseritura, ne nuk morem evidenca(prova) per masen ne te cilen publiku vendas eshte bere me dije per kete deklarate(Deklarata e bere nga ZvMinistri i METE, Neritan Alibali ne Konferencen e Dohas eshte tashme perfshire ne website te METE).

3.2 Treguesi 2 i Grides: A eshte Qeveria e perkushtuar qe te punoje me shoqerine civile dhe me kompanite per zbatimin e EITI?

Progresi deri tani

Kryeministri themeloi nje Grup Pune Nderinstitucional me urdherin e tij Nr. 156, date 12 dhjetor 2008, i ngritur per te vepruar nje Grup shume-veprimtaresh kryesore ne termat e Rregullave te EITI. Ky urdher cakton zvMinistrin e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes si kryetar i Grupit dhe pervec kesaj, identifikon 12 perfaqesues nga agjensi qeveritare si anetare te Grupit. Urdheri po ashtu deklaroi se ”perfaqesues nga organizata jofitimprurese, nga Banka e Shqiperise, nga Enti Rregullator i Energjise, nga grupet e interesit, nga Bashkimi i Dhomave te Tregtise dhe Industrise mund te marrin pjese ne takimin e Grupit te Punes, me ftese te kryetarit te tij”.

METE ftoi dy kompani te industrise nxjerrrese ne takimin e pare te Grupit te Punes me 17 mars 2009, si dhe nje OJF(Qendren per Zhvillim dhe Demokratizim te Institucioneve) per te perfaqesuar shoqerine civile. Ne prill 2009, METE ftoi nje numer te organizatave te shoqerise civile, te identifikuara ne konsultim me Banken Boterore, per te marre pjese ne EITI. Tete organizata u pergjigjen dhe deleguan nje perfaqesues(Drejtorin Ekzekutiv te Qendres per Zhvillim dhe Demokratizim te Institucioneve) per te qene anetar i Grupit te Punes nga shoqeria civile.

Plani i Punes EITI per vitet 2008-2011, si dhe plani i punes i Sekretariatit EITI per vitin 2011, miratuar nga Grupi i Punes ne janar 2011, qe te dy planifikojne masa per te angazhuar shoqerine civile dhe kompanite ne EITI. Ne komunikimet e tyre publike ne media, perfaqesuesit e METE dhe te sekretariatit ALBEITI(pas themelimit te tij ne nentor 2010) theksuan natyren me shume veprimtare dhe grupe interesi te EITI, si dhe rolin e rendesishem te luajtur nga shoqeria civile dhe kompanite ne kete proces.

Pikepamjet e veprimtareve kryesore

Te gjithë veprimtaret kryesore që marrin pjesë në Grupin e Punes, duke përfshirë përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe të kompanive, thanë se përkushtimi i qeverisë është i kënaqshëm. Disa organizata të shoqërisë civile, të konsultuara gjatë Validimit, vërejtën se përkushtimi i qeverisë i mungonte qëllimi dhe qëndrueshmëria. Sipas tyre, Qeveria nuk kishte bërë mjaftueshëm për të arritur dhe angazhuar shoqërinë civile në gjërësinë e saj, për në procesin EITI. Kompanitë e konsultuara gjatë Validimit nuk shprehën ndonjë pakënaqësi për nivelin e përkushtimit të qeverisë, por nuk mund të jepnin ndonjë shembull të përpjekjeve të qeverisë për t'u angazhuar me kompanitë përtej kërkesave për të dorëzuar të dhëna për raportin e rakordimit të pagesave. Në opinionin e veprimtareve kryesore të konsultuar, nuk ka pengesa në pjesëmarrjen e shoqërisë civile dhe të kompanive në proces. Përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe kompanive mund të flasin lirshëm për çështjet e transparencës dhe të qeverisjes së burimeve natyrore.

Vlerësimi i Validuesit

Qeveria është përkushtuar zyrtarisht për të punuar me shoqërinë civile dhe kompanitë për zbatimin e EITI. Grupi i Punes është mjete përsosur me të cilin qeveria angazhohet me shoqërinë civile dhe me kompanitë për zbatimin e EITI. Rezultati praktik i këtij përkushtimi në Grupin e Punes së EITI dhe nëpërmjet veprimtareve kryesore të shoqërisë civile dhe kompanive vlerësohet në seksionet 3.5, 3.6 dhe 3.7.

Ky tregues është arritur.

3.3 Treguesi 3 i Grides: A ka caktuar Qeveria një individ të lartë për të drejtuar zbatimin e EITI?

Progresi deri tani

Kryeministri emerit z/Ministrin e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës (METE) si kryetar të Grupit të Punes me Urdhërin e tij Nr. 156, datë 12 dhjetor 2008 (që nga ajo kohë deri tani është z. Neritan Alibali). Kuptojmë që emerimi është publikuar në Gazetën Zyrtare dhe është po ashtu në website të Këshillit të Ministrave dhe në website të METE. METE është agjensia qeveritare e ngarkuar me zbatimin e EITI në Shqipëri dhe z. Alibali personalisht gëzon besimin e të gjithë veprimtareve kryesore. Ai ka autoritet të përshtatshëm dhe liri për të koordinuar veprimin mbi EITI, përmes ministrive të linjës dhe agjensive, si dhe nëpërmjet Urdhërit të Kryeministrit.

Pikepamjet e veprimtareve kryesore

Te gjithë veprimtaret kryesore te konsultuar bien dakort se ky tregues eshte arritur.

Vleresimi i Validuesit

Ky tregues eshte arritur.

3.4 Treguesi 4 i Grides: A eshte publikuar dhe bere gjeresisht i arritshem nje

Plan Veprimi teresisht i kostuar(me kostot perkatese), i cili te permbaje

objektiva te matshem, nje plan kohor per zbatimin dhe nje vleresim

per kufizimet ne kapacitete(Qeveri, sektor privat dhe shoqeri civile)?

“ *Qellimi*: Plani i Punes i vendit eshte themeli i procesit te Validimit te vendit. Ky kriter i gjashte i EITI kerkon qe Plani i Punes te pergatitet, per te te bihet dakort me veprimtaret kryesore dhe te gjendet publikisht

Prova: Per te thene se ky tregues eshte arritur, kerkohet nga Validuesi qe te shohe prova se Plani i Punes eshte miratuar nga veprimtaret kryesore dhe qe ai permban:

- Objektiva te matshem;
- Nje liste kohore per zbatim;
- Nje vleresim te kufizimeve potenciale te kapaciteteve;
- Menyren se si qeveria do te siguroje natyren shumeperfshirese te veprimtareve kryesore te EITI, veçanerisht ne lidhje me angazhimin e shoqerise civile;
- Nje liste kohore per Validimin, gjate fazes kur nje vend eshte Kandidat. Kjo duhet te reflektoje nevojat e vendit, por duhet te ndodhe nje here ne dy vjet;
- Plani i Punes duhet gjithashtu te percaktoje se si qeveria do te paguaje per Validimin.

Validuesi ka nevoje te percaktoje progresin ne zbatimin e EITI, perkundrejt ketyre objektivave dhe listave kohore, si dhe te vleresoje nese nje vend ka vepruar mbi kufizime kapacitetesh te identifikuara.

Nje element kyç ne procesin e validimit te nje vendi do te jete nese lista kohore per zbatim respektohet ose jo. Nese lista kohore nuk respektohet, Validuesi-bazuar ne prova nga veprimtaret

kryesore dhe nga te tjere-do te kete nevoje te percektoje nese vonesat ne respektimin e listes kohore jane te aresyeshme. Ne rast se ato jane te paarsyeshme, Validuesi mund te kete nevoje te konsideroje nese duhet te rekomandoje qe vendi te dale nga lista e vendeve kandidate, apo jo”.

Progresi deri tani

Plani i Punes EITI per Shqiperine u pergatit me ndihmen e Bankes Boterore dhe mbulon nje periudhe nga 2009 deri ne 2011. Plani u aprovua ne takimin e pare e Grupit te Punes EITI me 17 mars 2009, takim i ndjekur, ndermjet te tjereve, dhe nga nje perfaqesues i komunitetit te biznesit.

Sipas METE, plani i punes u pergatit nga stafi i Ministrise dhe pastaj ju paraqit veprimtareve te tjere kryesore(kompanive dhe shoqerise civile). Nje perfaqesues i shoqerise civile dhe nje perfaqesues i industrise nxjerrese e moren draftin e planit te punes ne avance dhe kishin shume kohe per te bere komentet dhe sugjerimet e tyre. Nje perfaqesues nga shoqeria civile dhe dy perfaqesues nga kompanite moren pjese ne takimin e Grupit te Punes me 17 mars 2009, takim i cili diskutoi dhe miratoi Planin e Punes. Megjithate procesi me te cilin keta perfaqesues u zgjodhen nga qeveria nuk eshte i qarte, perderisa ftesa tek kompanite per t’u bashkuar me EITI u dergua ne prill 2009 dhe vendimi i tete OJF-ve per te caktuar ate OJF(Qendren per Zhvillim dhe Demokratizim te Institucioneve) si perfaqesues te tyren ne Grupin e Punes nuk ndodhi perpara prillit 2009. METE ka shpjeguar se pati nje prezantim te planit te punes ndaj nje shumellojshmerie veprimtaresh kryesore me daten 18 maj 2009, por detajet e ketij prezantimi dhe kush mori pjese ne te nuk jane dhene.

Pjesa me e madhe e objektivave te prezantuara ne planin e punes jane te matshem, megjithate, sikurse kemi shpjeguar me siper, synimet e Objektivit 3(Hiq pengesat ndaj EITI/ndertimit te kapaciteteve dhe aksesit ne publik) nuk jane formuluar ne menyre precize, pasi nuk ka aktivitete specifike te percaktuara dhe nuk ka lista kohore per eventet. Kjo e ben matjen e tyre te pamundur dhe pengon zbatimin efektiv. Per fat te keq, ky eshte nje objektiv qe supozohet te siguroje natyren e pasjes se shume veprimtareve kryesore te EITI, nepermjet disa aktiviteteve, sikurse ndertimi i kapaciteteve dhe trajnimi per shoqerine civile(duke perfshire edhe median) dhe per kompanite mbi EITI dhe mbi çeshtjet e sektorit te minierave dhe naftes, po ashtu si dhe shperndarja ne publik e informacionit. Rritja e ndergjegjesimit dhe e kapaciteteve te kompanive dhe shoqerise civile, sikurse eshte vene re edhe ne vende te tjera ne kete raport, eshte nje fushe qe kerkon vemendje ne Shqiperi. Eshte me vecanerisht me rendesi qe ky Objektiv 3 te percaktohet ne nivelin e duhur te detajeve. Edhe pse synimi per te siguruar natyren me shume veprimtare kryesore te EITI duket qarte, plani ekzistues nuk e specifikon se si ky objektiv do te arrihet.

Plani i punes po ashtu permban nje liste kohore per zbatim, duke perfshire nje liste kohore per Validimin. Te gjitha aktivitetet e planit te punes jane te kostuara dhe burimet e financimit jane te

identifikuara, duke përfshirë fonde për Validimin. Megjithatë, nuk ka vlerësim për kufizimet potenciale të kapaciteteve në këtë plan pune.

Plani i punës është i arritshëm nga publiku në website të METE në shqip dhe anglisht:

www.mete.gov.al/...

Progresi përkundrejt planit të punës është shpjeguar në seksionin 2 më sipër.

Pikepamjet e veprimtareve kryesore

Veprimtaret kryesore që në konsultim ishin të mendimit që plani i punës përfaqëson shumë mirë idetë dhe interesat e të gjithë veprimtareve. Ata e pranojnë se disa aktivitete të planifikuara u zbatuan me vonë nga lista kohore dhe se disa aktivitete që duhej të ishin përfunduar janë ende në progres, ose nuk kanë filluar akoma (sikurse shpërndarja e raportit të rakodimit të pagesave të EITI, për shembull). Në të njëjtën kohë, veprimtaret kryesore ndjejnë që në teresi plani i punës është zbatuar.

Vlerësimi i Validuesit

Rregullat e EITI dhe Udhëzuesi i Validimit deklarojnë se “një element kyç në procesin e Validimit të një vendi do të jetë nëse lista kohore për zbatim është respektuar”. Sikurse u përshkrua më sipër, lista kohore nuk u respektua. Kjo duket se ka ndodhur për shkak të kushteve ekonomike dhe politike në Shqipëri gjatë periudhës, të cilat e penguan zbatimin, si dhe për shkak të vonës në themelimin e Sekretariatit shqiptar të EITI. Në dritën e aktiviteteve që përfunduan në vitin 2011, si përpara dhe pas vizitës së Validimit, nuk duket e paarsyeshme që t’i atribuosh vonesat e mëparshme shkaqeve të mësipërme.

Zbatimi i programit të punës së EITI është përmirësuar në mënyrë domethënëse pasi u bë veprues Sekretariati lokal i EITI në fund të vitit 2010, dhe kështu muajt e fundit kanë parë një fluks aktivitetesh që synonin të përmbushnin të gjitha objektivat e EITI.

Aktiviteti i ulët në vitin 2010 nënkupton që zbatimi mbeti prapa objektivave të planit të punës dhe një plan i ri pune është draftuar kohët e fundit, duke mbuluar periudhën deri në vitin 2013. Një kopje të këtij plani, i cili është ende në diskutim në Shqipëri, është përfshirë në Shtojcën 3 të raportit. Ai mban orientime për një raport të dytë EITI, i cili do të prodhohet gjatë periudhës dhjetor 2011-janar 2012, me një datë të planifikuar publikimi në shkurt 2012.

Duke patur parasysh pikepamjet e shprehura nga veprimtaret kryesore dhe progresin e bërë në vitin 2011, është e vështirë të konkludosh se treguesi nuk është arritur, edhe pse ka fusha

kuprogres i metejshe kerkohet(shiko seksionet e metejshe 5.2, pikat 2 dhe 3 per rekomandimet tona per permiresim).

Ne permbledhje, pas nje fillimi te mire ne vitin 2008 dhe ne fillim te vitit 2009, pak progres u arrit deri ne fund te vitit 2010. Nderkohe qe shume eshte arritur gjate 3-4 muajve te pare te vitit 2011, ka dokumentacion te pamjaftueshem gjate kohes se Validimit, per nje zbatim te qendrueshem, per te qene te afte te konkludojme mbi qendrueshmerine e ardhshme te EITI ne Shqiperi.

Treguesi eshte arritur, megjithese ka shume fusha ku veprime te metejshe jane te deshirueshme.

3.5 Treguesi 5 i Grides: A ka themeluar Qeveria nje grup nderinstitucional per te mbikqyrur zbatimin e EITI?

Qellimi: Zbatimi i EITI duhet te mbikqyret nga nje grup qe perfshin veprimtaret kryesore te duhur, duke perfshire-por jo duke u kufizuar vetem me ate-sektorin privat, shoqerine civile(duke perfshire grupe te pavarura te shoqerise civile dhe shtresa te tjera te shoqerise civile, si median dhe parlamentaret) dhe ministri qeveritare te linjes(duke perfshire drejtues qeveritare). Grupi duhet te miratoje terma publike te references. Keto terma duhet se paku te perfshijne: miratimin e Planit te Punes se vendit-duke u pasuar me rishikime, nese eshte e nevojshme; zgjedhjen e nje auditori, i cili te beje audite kur te dhenat e dorezuara per rakordim nga kompanite ose nga qeveria nuk bazohen mbi te dhena te kontrolluara nga standarde nderkombetare; zgjedhjen e nje organizate per te kryer rakordimin; si dhe fusha te tjera veprimi, sikurse permenden ne Griden(Listen) e Validimit.

Prova: Per te thene se ky tregues eshte arritur, kerkohet nga Validuesi qe te shohe prova se nje grup me veprimtaret kryesore eshte formuar, se ky grup perfshin veprimtaret kryesore te duhur dhe se termat e references se veprimtarise se tij perputhen me qellimin. Prova duhet te perfshije:

- Vleresimin e veprimtareve kryesore nese ky qellim eshte arritur;
- Informacion mbi anetaresine e grupit nderinstitucional te punes:
 - A ishte ftesa per te marre pjese ne grup e hapur dhe transparente?

- A janë veprimtaret kryesore të përfaqësuar si duhet?(kjo nuk nënkupton se veprimtaret kryesore duhet të përfaqësohen në mënyrë të barabartë)
- A e ndjejnë veprimtaret kryesore se ata janë të përfaqësuar si duhet?
- A e ndjejnë veprimtaret se ata mund të veprojnë si pjesë e komitetit- duke përfshirë lidhjen e tyre me grupet e tyre të përfaqësimit dhe me veprimtaret e tjera- të lira, pa ndikime të tepruara apo kanosje?
- A janë grupet e shoqërisë civile në veprim, si dhe në terma të politikave të tyre, të pavarura nga qeveria dhe/ose sektori privat?
- Aty ku anëtarët e grupit kanë ndryshuar, ka patur ndonjë sugjerim presioni apo ndonjë tentativë për të futur anëtarë që nuk do ta sfidonin statukuonë?
- A kanë kapacitete të mjaftueshme anëtarët e grupit për të marrë përsipër detyra?
- A i japin termat e referencës Komitetit një zë mbi zbatimin e EITI? Këto terma të referencës duhet të paku të përfshijnë: miratimin e Planit të Punes së vendit- duke u pasuar me rishikime, nëse është e nevojshme; zgjedhjen e një auditori, i cili të bëjë auditë kur të dhenat e dorëzuara për rekordim nga kompanitë ose nga qeveria nuk bazohen mbi të dhëna të kontrolluara nga standarde ndërkombëtare; zgjedhjen e një organizate për të kryer rekordimin; si dhe fusha të tjera veprimi, sikurse përmenden në Griden(Listen) e Validimit.

Progresi deri tani

Themelimi dhe përberja

Grupi i veprimtareve kryesore për të mbikqyrur zbatimin e EITI u krijua me Urdhër të Kryeministrit Nr. 156 datë 27 dhjetor 2008, me emrin Grupi Nderinstitucional i Punes. Ky urdher specifikon detyrën e Grupit të Punes, që të: "marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar realizimin e planit të veprimit, të përgatise të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, me qëllim që të realizojë fillimin e procesit të Validimit drejt kandidimit të Shqipërisë si një vend zbatues kandidat për në EITI, si dhe të realizojë kandidimin e Shqipërisë me të drejta të plota, si një vend zbatues i kësaj nisme".

Urdherit thekson natyrën shumëpaleshe të Grupit të Punes dhe përmend një rang të gjere veprimtarësh kryesore potenciale, duke deklaruar që "përfaqësues nga organizatat jofitimpruresë, nga Banka e Shqipërisë, nga Agjencia e Rregullimit të Energjisë, nga grupet e interesit, nga

Bashkimi i Dhomave të tregtisë dhe industrisë mund të marrin pjesë në takimin e grupit të punës, me ftesë nga kryetari i tij”.

Megjithatë përcaktimin e gjere të veprimtareve kryesore potenciale, vetëm një segment i shoqërisë civile është përfaqësuar në Grup-organizatat jo qeveritare. METE shpjegoi se një analizë informale për veprimtaret kryesore ishte kryer, përpara se sa të vendosej përberja e grupit të punës. Përsa i përket shoqërisë civile, Banka Botërore ishte konsultuar mbi zgjedhjen e organizatave të rëndësishme jo qeveritare. Megjithatë, nuk ishte kryer një analizë formale e veprimtareve kryesore dhe ftesa origjinale për të marrë pjesë në Grupin e Punës EITI, e lëshuar nga qeveria për shoqëri civile, nuk na u dha. Përzgjedhja e një përfaqësuesi të vetëm të shoqërisë civile në Grupin e Punës për pjesën më të madhe të kohës që grupi ishte themeluar, u bë vetëm nga tërë organizatat dhe ndërmjet organizatave të shoqërisë civile jo të përfaqësuara në Grupin e Punës, të kontaktuar gjatë Validimit, vetëm dy prej tyre e dinin kush i përfaqëson ato në Grupin e Punës. Kjo të sugjeron se përfaqësimi nuk ishte i duhuri.

Mungesa e qartësisë lidhur me anëtarësimin në Grup, e kombinuar me vendimin për të rritur përfaqësimin e kompanive dhe të shoqërisë civile në Grupin e Punës, të marrë vetëm pak ditë përpara vizitës sone, me sugjerim të Sekretariatit Ndërkombëtar të EITI (Tim Bittiger), ndërsa Grupi i Punës po konsideronte çështje të lidhura me procesin e Validimit; këto nuk janë konsistente me punën me shoqëri civile dhe kompanite, gjatë zbatimit të EITI.

Kërkesa jone fillestare, e dale më 31 mars 2011 për një listë të anëtarëve të tanishëm dhe të kaluar të Grupit të Punës EITI, me detajet e plotë të kontaktit të tyre, sollë një listë prej 12 zyrtarësh të qeverisë. Në kërkim sqarime, duke përfshirë përfaqësimin e kompanive dhe të shoqërisë civile, dhe na dhënë listë shtesë (Listë e anëtarëve të dhënë për ne nga Sekretariati më 20 prill 2011 përfshin tre anëtarë nga shoqëria civile dhe katër nga kompanite. Listë e dorëzuar më datë 26 prill përmendte pesë përfaqësues të shoqërisë civile dhe pesë përfaqësues të sektorit privat. Në nuk e dime përse, si dhe nga kush u bënë këto ndryshime. Për më tej, një nga kompanite, e cila, sipas listës së dhënë nga Sekretariati, rezultonte një anëtarë e Grupit të Punës, e mohoi që ishte anëtarë. Listë që është bërë publike e anëtarëve të Grupit të Punës, e publikuar në seksionin për EITI të website të METE, jep vetëm emrat e Grupit të Punës nga agjensite qeveritare (krahëso me listën e dhënë tek në fillim), për më 29 prill 2011), ku ishin dhe përfaqësues nga këta veprimtarë kryesore. Gjatë prezantimit të tonë të gjetjeve fillestare tek Grupi i Punës më datë 22 prill, në kërkim një listë përfundimtare të anëtarëve dhe detaje të plotë të kontakteve të tyre, se bashku me konfirmimin e caktimit të tyre anëtarë dhe data në të cilën u bënë anëtarë (ose dhënë dorëheqjen, nëse ka rastë). Ky informacion nuk na është dhënë.

Veprimtaret kryesore të cilët në takim, ishin të paqartë lidhur me anëtarësinë e tyre në Grup. Ishte gjerësisht e njohur që Ilir Aliaj përfaqëson shoqëri civile, si dhe disa anëtarë të tjere - për shembull, Kryetari i grupit - u përmenden. Megjithatë, përfaqësimi i kompanive nuk ishte i njohur mirë, madje edhe mes vete kompanive dhe shumë individë u përmenden. Kjo ishte tejet masë e papëlqyeshme.

Nje pjese e konfuzionit mund te dale nga praktika e te ftuarit te nje pjesemarrjeje te gjere ne disa takime, me me shume se vete anetaret e Grupit. Keshtu qe edhe pjesemarres nga kompanite “jo anetare” dhe nga organizatat e tjera te shoqerise civile jane te pranishem. Kjo duket se eshte nje perpjekje e paster per transparence, mirepo mungesa e qartesis lidhur me procedurat te çon ne konfuzion lidhur me cilesine ne te cilen njerezit jane duke marre pjese ne takim. Paqartesia mes anetaresise dhe perfaqesimit mund te çojë ne komunikim te varfer brenda perfaqesuesve ne Grupin e Punes dhe grupeve te tyre te interesit.

Duket se deri ne prill 2011, Grupi i Punes kishte 15 anetare:

- Kryetarin (zvMinister i METE)
- 12 perfaqesues te agjensive te ndryshme qeveritare(dy nga METE, dhe nje nga secila prej institucioneve si me poshte: Ministria e Financave, Ministria e Puneve te Jashtme, Ministria e Drejtesisë, Ministria e Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta, Drejtoria e Pergjithshme e Taksave, Drejtoria e Pergjithshme e Doganave, Instituti i Statistikes, Agjensia Kombetare e Burimeve Natyrore, Sherbimi Gjeologjik Kombetar, Agjensia e Konçesioneve);
- nje perfaqesues nga kompanite(Shoqata e Investuesve te Huaj te Shqiperise-FIAA)
- nje perfaqesues nga shoqeria civile(Qendra per Zhvillim dhe Demokratizim te Institucioneve).
- Zyrtaret e larte te qeverise perfaqesohen ne grupin nderinstitucional nga Zvministri i METE dhe 6 drejtores nga agjensi te tjera shtetore. Keshtu, niveli i perfaqesimit qeveritar eshte i pershtatshem per zbatimin e EITI.
- Ne prill 2011, nje vendim u muar qe te rritej anetaresia ne Grupin e Punes, duke shtuar perfaqesues nga shoqeria civile(organizata jo-qeveritare) dhe nga komuniteti i biznesit. Procedurat per caktimin e anetaresive te Grupit te Punes nga shoqeria civile dhe kompanite jane te paqarta, veçanerisht persa i perket anetaresive te rinj te identifikuar ne prill 2011. Nuk ka ndonje evidence te ndonje diskutimi nga Grupi i Punes lidhur me zgjerimin e anetaresise, as edhe nese shoqeria civile gjerisht apo edhe kompanite te jene angazhuar ne debate lidhur me anetaret shtese.

Ndryshimi i perberjes

Nje Urdher i ri i Kryeministrit(Nr. 71 date 21 korrik 2011) zevendeson Urdherin e meparshem te dhjetorit 2008 dhe e cakton anetaresine e Grupit te Punes sikurse ketu me poshte, perveç zvMinistrit te METE:

- a) Nje anetar nga METE;
- b) Nje anetar nga Ministria e Finances
- c) Nje anetar nga Ministria e Drejtesise
- d) Nje anetar nga Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve
- e) Nje anetar nga Agjensia Kombetare e Burimeve Natyrore
- f) Nje anetar nga Sherbimi Gjeologjik Shqiptar
- g) Pese anetare nga biznesi, te zgjedhur nga Rrjeti Kombetar i Industrise Nxjerrese
- h) Pese anetare nga shoqeria civile, te zgjedhur nga Rrjeti Kombetar i Shoqerise Civile per EITI.

Urdheri po ashtu siguron se “niveli i perfaqesimit ne kete Grup per institucionet shteterore nuk do te jete me i ulet se ai i drejtorit te Drejtorise ne nje ministri”.

Teksti ne anglisht i Urdherit(na eshte dhene nga Sekretariati ALBEITI) dhe letrat e emerimit te specifikuara nga Urdheri i Kryeministrit(dhene serisht nga Sekretariati ALBEITI), perfshihen ne Shtojcen 4.

Lista e plote e anetareve sipas Urdherit Nr. 71 te kryeministrit eshte:

<u>Emri</u>	<u>Perfaqeson</u>
	Kryetari i Grupit te Punes
	METE
	Ministria e Finances
	Ministria e Drejtesise
	Drejtoria e Pergjithshme e Taksave
	AKBN
	Sherbimi Gjeologjik Shqiptar
	Kompani
	Kompani
	Kompani
	Kompani

Kompani

Shoqeri Civile

Shoqeri Civile

Shoqeri Civile

Shoqeri Civile

Shoqeri Civile

Termat e references dhe rregullat e procedures

Nuk jane zhvilluar terma reference per Grupin e Punes per te identifikuar qellimin e tij te punes dhe pergjegjesite, duke perfshire kerkesat minimale te listuara ne Rregullat e EITi dhe ne Udhezuesin e Validimit. Perfaqesuesit e qeverise argumentuan se termat e references jane te percaktuara ne Urdherin e kryeministrit qe themelon Grupin e Punes, edhe pse ky nuk ishte rasti. Urdheri permban nje kerkese qe Grupi i Punes duhet te marre persiper te gjitha aktivitetet e nevojshme per te...realizuar kandidimin e Shqiperise si nje vend qe kerkon anetaresim. Megjithate, hapat e detajuara te listuara ne IAT 5-miratimi i Planit te Punes, zgjedhja e auditorit per te marre persiper auditet, kur te dhenat e dorezuara nuk jane tashme te bazuara ne te dhenat e audituara sipas standardeve nderkombetare, etj.- nuk jane percaktuar, sikurse do te ishte rasti ne termat e references. Perfshirja e ketyre hapave kaq te detajuar ne nje dokument qe u drejtohet anetareve te nje grupi qe jo domosdoshmerisht jane te familjarizuar me kerkesat e EITI, do te ishte nje veprim informues dhe do t'i fuqizonte anetaret e grupit.

Grupi i Punes i permbushi kerkesat e specifikuara nen EITI-per shembull, te konsideroje dhe te caktoje nje Rakordues, si dhe te miratoje Raportin e Rakordimit te Pagesave.

Nuk ka rregulla te shkruara per proceduren, sidomos per Grupin e Punes. Sipas perfaqesuesve te qeverise, Grupi i Punes perdor rregulla te pergjithshme te procedures per institucione qeveritare. Ne nuk morem nje kopje te ketyre rregullave, por sipas qeverise, rregullat percaktojne nje kerkese kuorumi prej 50% plus nje te numrin total te pjesemarrsesve, si dhe vendim marrjen me nje shumice te thjeshte votash.

Ne vrojtuam takimin ne te cilin Grupi i Punes konsideroi draft raportin e rakordimit te pagesave. Ky takim u ndoq nga shume perfaqesues te kompanive dhe te OJF-ve, por qe nuk ishin ne listen e anetareve, sipas qeverise. Pati pak diskutim lidhur me raportin, nga ana e pjesemarrsesve. Ne perfundim te takimit, pati nje mbledhje te anetareve te Grupit te Punes per nje votim formal ndaj raportit. Kjo procedure na u konfirmua ne intervista me perfaqesues te qeverise.

Minutat(shenimet) e takimeve qe na u dhane ishin ne shume raste kopje te shenimeve me shkrim dore, te lidhura bashke ne nje bllok shenimesh. Nuk ka procedure per t'i qarkulluar keto minuta mes anetareve te Grupit te Punes(kur u intervistuan, anetaret nuk komentuan ne kete) dhe minutat e secilit takim nuk jane zyrtarisht miratuar si nje dokument i takimit.

Termet e amenduara te references dhe rregullat e procedures

Urdheri i Kryeministrit date 21 korrik 2011 po ashtu parashikon qe “Sekretariati i Nismes se Transparences ne Industrine Nxjerrrese(EITI) duhet te pergatise draftin e Akt Rregullores per funksionimin e Grupit te Punes te Nismes se Transparences ne Industrine Nxjerrrese(EITI), akt i cili miratohet nga Ministri i Ekonomise, tregtise dhe Energjitikes”. Nje kopje te termave te references, te draftuara nga Sekretariati ALBEITI perfshihet ne Shtojcen 5.

Ne besojme se Termet e References dhe rregullat e procedures mund te permiresohen dhe japim rekomandime per kete ne seksionin 5.2.5.

Funksionimi i Grupit te Punes

Nuk ka prova se grupet e shoqerise civile, te perfshira ne EITI si anetare te Grupit te Punes, mund te jene, ne ndonje menyre, nga ana e veprimit ose e politikave, te varura nga qeveria dhe/ose kompanite. Te gjitha anetaret e Grupit te Punes, te intervistuar gjate Validimit, deklaruan se ata veprojne te lire, pa kufizim apo presione, duke perfshire lidhjen me grupet e tyre te perfaqesimit dhe interesit.

Anetaret e Grupit te Punes moren pjese ne kater workshop-e trajnimi dhe ne nje seminar. Keto u kryen nga Banka Boterore, nga Sekretariati Nderkombetar i EITI dhe nga qeveria.

Anetaret e Grupit te Punes nga shoqeria civile dhe nga kompanite moren pjese ne projektimin, vrojtimin dhe vleresimin e procesit te EITI, si dhe kontribuan ne debatin publik, nepermjet pjesemarrjes ne eventet e medias. Ata po ashtu moren pjese ne zgjedhjen e administratorit te pavarur per raportin EITI te rakordimit te pagesave(per me shume detaje, shih Treguesin 5).

Anetaresia e Grupit te Punes deri tani vone(12 anetare plus Kryetarin qe perfaqesonin qeverine, si dhe nje perfaqesues per shoqerine civile dhe nje per kompanite), ne kombinim me kerkesen e kuorunit(50% plus nje) dhe me procedurat e votimit qe kerkojne nje vote shumice per vendimet, i jep autoritet jo efektiv pjesemarrjesve jo-qeveritare.

Referimi i urdherit te Kryeministrit qe “perfaqesues nga(institucione te ndryshme) mund te marrin pjese ne takimin e grupit te punes, me ftese nga kryetari i grupit te punes” eshte futur ne praktike vetem pjeserisht. Per shembull, listat e pjesemarrjes se 11 minutave(shenimeve te takimit) te Grupit te Punes mes 17 marsit 2009 dhe 23 dhjetorit 2010 nuk tregojne ndonje

pjesemarrje te shoqerise civile, me shume se sa dy ose tre pjesemarres te rregullt te shoqerise civile. Ne disa takime te Grupit te Punes, per shembull ne prezantimin e raportit EITI te rakordimit te pagesave, pane nje pjesemarrje me te gjere te shoqerise civile. Ne te njejten kohe, aktivitetet me te fundit sugjerojne se grupi i Punes eshte duke punuar aktivisht per te permiresuar perfaqesimin e shoqerise civile(ritje ne anetaresine e Grupit te Punes, perpjekje per te krijuar grupet lokale te mbeshtetjes se EITI, angazhimi i OJF-ve te reja ne Tirane, etj.).

Na eshte thene se, se se paku nje perfaqesues i shoqerise civile dhe nje perfaqesues i kompanive ka marre pjese ne shumicen dermueese te takimeve te Grupit te Punes. Megjithate, nuk kishte pjesemarrje te shoqerise civile apo te kompanive ne mbledhjen e Grupit te Punes me 25 shkurt 2011, mbledhje e cila konsideroi zgjedhjen e Validuesit te EITI.

Aktiviteti i Grupit te Punes nuk ka qene i njetrajtshem. Takimet per te cilat na jane dhene minutat jane vendosur ne tabelen si me poshte(deri ne fund te marsit 2011). Mund te shikohet se niveli i aktivitetit ne dy tremujoret e fundit eshte rritur dukshem. Kater takime te Grupit te Punes ne tremujorin e katert te vitit 2010 jane kryer ne intervalin 23 deri ne 30 nentor 2010.

Vitet	Tremujoret	Nr i takimeve te Grupit te Punes
2009	Trem 3	1
	Trem 4	2

2010	Trem 1	1
2010	Trem 2	1
2010	Trem 3	2
2010	Trem 4	5

2011	Trem 1	6

Ne kemi kerkuar, por nuk kemi marre, nje liste pjesemarrjeje per secilin takim te Grupit te Punes.

Pikepamjet e veprimtareve kryesore

Disa nga anetaret e Grupit të Punes, të kontaktuar gjatë Validimit, ishin të kenaqur me përberjen e Grupit të Punes dhe përshatshmerinë e përfaqësimit të shumë veprimtareve kryesore. Ata thanë se ata e konsideronin që kapaciteti i tyre për të kryer detyrat e tyre ishte i përshatshëm, edhe pse ata pranuan që ka vend për përmirësim.

Anetaret e Grupit të Punes ndihen të lirë të veprojnë, pa patur përsion ose ndikim negativ, për të shprehur opinionet e tyre dhe për t'u lidhur me grupet e tyre të përfaqësimit apo interesit.

Disa anetare, megjithatë, shprehen shqetësuar lidhur me rregullat ekzistuese të procedurës, të konsideruara që anonin për nga qeveria, si dhe lidhur me mungesën e ekspertizës së disa anetareve të Grupit të Punes në çështjet teknike. Organizimi i punës ishte një tjetër shqetësim i nënvizuar nga disa anetare të Grupit të Punes, të cilët besojnë se një anetaresi më e madhe e ben Grupin jo efikas dhe nuk çon në vendim-marrje prodhimore. Disa anetare-nga të gjitha grupet e veprimtareve kryesore- shprehen pikepamjen se përfaqësia e shoqërisë civile dhe ndoshta edhe përfaqësia e sektorit privat nuk i përfaqëson si duhet këto grupe dhe duhet zgjeruar.

Veprimtaret kryesore që nuk bëjnë pjesë në Grupin e Punes, të kontaktuar gjatë Validimit (organizata jo-qeveritare dhe kompani) ishin në teresi të pa ndërgjegjesuara ose informuara për përfaqësimin e tyre në Grupin e Punes.

Vlerësimi i Validuesit

Grupi Nderinstitucional i themeluar në dhjetor 2009 nga Urdhëri i Kryeministrit është jo efikas në shumë mënyra:

- I. Baza e ftesës origjinale për të marrë pjesë në të nuk është e qartë
- II. Anetësia nuk është e qartë dhe nuk dihet nga të gjithë
- III. Veprimtaret kryesore janë konfuzë për përfaqësimin e tyre dhe prandaj nuk mund të thuhet se ata janë përfaqësuar si duhet.
- IV. Procesi për rënien dakort në ndryshimet në anetaresi dhe në caktimin e anetareve nuk dihet
- V. Duke patur procedurat e shumica të votës, me të cilat Grupi i Punes vepron dhe vendos, përfaqësimi i kompanive dhe i shoqërisë civile është i papërshtatshëm, në krahasim me 12 anetaret, plus Kryetarin, nga ana e qeverisë.
- VI. Kërkesa e kuorumit për takimet nuk kërkon praninë dhe pjesëmarrjen e anetareve të secilit nga grupet e interesit (qeveri, kompani, shoqëri civile)

VII. Grupi i Punes nuk ka miratuar terma reference.

Shenimet e takimeve dhe vendimeve nuk jane bere subjekt i nje kontrolli te pershtatshem dhe miratimi. Urdheri i Kryeministrit i korrikut 2011 dhe draft Termat e References dhe rregullat e procedures te pergatitura nga sekretariati ALBEITI ndryshojne ne menyre thelbesore anetaresine ne Grupin e Punes, duke rritur perfaqesimin e kompanive dhe te shoqerise civile dhe duke vendosur formalisht, per here te pare, pergjegjesite dhe procedurat e Grupit te Punes. Procesi ku kompanite dhe shoqatat e shoqerise civile behen pergjegjese per emerimin e anetaresve te Grupit te Punes nuk pershkruhet.

Ne kemi bere rekomandime per ndryshimet ne rregullat e procedures ne seksionin 5.2.5.

Ndryshimet e fundit te Grupit te Punes dhe te procedurave te tij jane nje permiresim ne menyren se si funksionote ky grup qe nga koha e hyrjes se Shqiperise ne procesin EITI deri ne kohen e vizites sone ne prill 2011. Eshte shume heret te themi se si rregjimi i ri do te veproje dhe ne e vendosim vleresimin tone tek strukturat aplikuese qe nga data e aderimit ne EITI deri ne korrik 2011.

Ky tregues nuk eshte arritur.

3.6 Treguesi 6 i Grides: A eshte shoqeria civile e angazhuar ne proces?

“ Qellimi: Ky tregues perforcon Treguesin 5. Kriteri EITI kerkon qe shoqeria civile te jete e angazhuar ne menyre aktive si pjesemarrese ne projektimin, vrojtimin dhe vleresimin e procesit, si dhe qe ajo te kontribuojte ne debatin publik. Per te arritur kete, zbatimi i EITI ka nevojte per nje angazhim te gjere te shoqerise civile. Kjo mund te realizohet nepermjet grupit nderinstitucional, ose pervec grupit te veprimtareve kryesore, me forma te tjera.

Prova: Per te miratuar kete tregues, Validuesi duhet te shohe prova se qeveria dhe grupi i veprimtareve kryesore ishin te duhurit dhe kane synuar te angazhojne veprimtaret kryesore te shoqerise civile ne procesin e zbatimit te EITI. Kjo duhet te perfshije provat e meposhtme:

- Aksesi nga ana e grupit te veprimtareve kryesore ne grupe me te gjera te shoqerise civile, duke perfshire komunikimet (mediat, website, letra) me grupet dhe/ose koalicionet e shoqerise civile (per shembull, te nje koalicioni lokal “Publiko çfare paguan”), duke i

informuar ato per angazhimin e qeverise per te zbatuar EITI, si dhe per rolin qendror te qeverise dhe te shoqerise civile;

- Veprime per te rregulluar limitet e kapaciteteve qe pengojne pjesemarrjen e shoqerise civile, te ndermarra nga qeveria, shoqeria civile ose kompanite;
- Grupet e shoqerise civile te perfshira ne EITI duhet te jene ne veprime dhe ne politiken qe ndjekin te pavarura nga qeveria dhe/ose nga sektori privat;
- Grupet e shoqerise civile te angazhuara ne EITI jane te lira te shprehin opinionet e tyre mbi EITI, pa influenca apo presione.”

Progresi deri tani

Qeveria veproi per te patur akses me gjere ne grupet e shoqerise civile, ne nisje te procesit te EITI ne fillim te vitit 2009, duke i derguar nje ftese nje numri te ketyre grupeve per te hyre ne EITI. Nuk kemi mundur te marrim ftesen fillestare drejtuar organizatave te shoqerise civile dhe nuk mund te themi se sa organizata ishin te ftuara. Qe nga atehere, qeveria ka dhene dhe marre me nje grup prej 8-10 OJF me baze ne tirane, te cilat shprehen interesin e tyre per EITI. Nuk kemi pare prova te perpjekjeve te tjera te qeverise, perpara marsit 2011, per te rritur numrin e grupeve te shoqerise civile te angazhuara ne EITI.

Te tre OJF-te qe jane perfshire aktivisht ne Grupin e Punes(Qendra per Zhvillim dhe Demokratizim te Institucioneve, Qendra per Zhvillim dhe Integrim dhe Qendra per Transparence dhe Informim te Lire) nuk kane nje faqe interneti ose forma te rregullta komunikimi(te tilla si buletinet) dhe thane se ato informojne shoqatat e tjera te shoqersie civile lidhur me EITI nepermjet e-mail ose komunikimit personal, mbi baza te perkohshme. Ne shtator 2010, te tre organizatat e lartpermendura lansuan nje projekt, me mbeshtetjen financiare te Fondacionit Soros ne Shqiperi, per te themeluar nje rrjet lokal ne mbeshtetje te EITI. Per kete qellim, te tri OJF-te shperndane pyetesore tek zyrtaret e qeverisjes lokale, tek OJF-te, tek sindikatat dhe bizneset ne pese rrethe te Shqiperise, qe kane perqendrim te larte te industrise nxjerrrese, per te zbuluar interesin e tyre per t'u perfshire ne EITI. Sipas OJF-ve, 60 persona dhe organizata kane shprehur interesin e tyre dhe aktivitete, te tilla si sesione trajnimi dhe fushata ndergjegjesimi priten te fillojne ne te ardhmen e afert. Nuk ka patur aktivitete qe te perfshijne kete rrjet akoma. Po ashtu, po behen pergatitje nga nje grup OJF-esh per te thirrur nje konference nderkombetare ne Tirane, mbi pjesemarrjen e OJF-ve ne EITI, nga tetori 2011.

Workshop-e trajnimi per shoqerine civile jane zhvilluar ne Shtator dhe Tetor 2009 dhe trajnim i metejshem eshte planifikuar qe nga Maji 2011, i fundit i financuar nga Forumi i Shoqerise se Hapur.

Dy perfaqesues te shoqerise civile moren pjese si pjese e delegacionit shqiptar ne Konferencen EITI ne Paris me 2-3 mars 2011. Perfaqesuesi i shoqerise civile ne Grupin e Punes u ftua te marre pjese ne debate televizive per EITI ne prill 2011.

Pikepamjet e veprimtareve kryesore

Anetaret e shoqerise civile te Grupit te Punes shprehen kenaqesi me perfaqesimin e tyre, por besojne se ai mund te rritet. Perfaqesuesit e shoqerise civile ne Grupin e Punes ndjejne se atyre u eshte dhene njoftim i mjaftueshem perpara per takimet qe do te zhvillohen, si dhe akses ne kohe ne dokumentat qe do te debatohen dhe per te cilat do te propozohet pershtatja. Ata ndihen te lire te shprehin opinione per EITI, pa influencia agresive apo presion.

Disa organizata te shoqerise civile, te konsultuara gjate Validimit, u shprehen se angazhimit qeveritar i mungonte qellimi dhe qendrushmeria. Sipas tyre, Qeveria nuk ka bere mjaftueshem te kete akses dhe te angazhoje nje shoqeri civile me te gjere me procesin e EITI.

Disa OJF te kontaktuara gjate Validimit mendojne se shoqeria civile, pertej tre organizatave me anetaresim ne Grupin e Punes, nuk eshte mjaftueshem e perfshire ne zbatimin e EITI. Ne veçanti, ato shprehen shqetesim mbi mungesen e angazhimit te shoqerise civile ne zonat me perqendrim te larte te industrive nxjerrese.

Te tria grupet e shoqerise civile te perfshira ne EITI thane se ato jane si veprimtari dhe ne nivel te politikave qe ndjekin te pavarura nga qeveria dhe/ose sektori privat. Ato jane te lira te shprehin opinionet e tyre mbi EITI pa influence agresive apo kanosje e presione. Ato thane qe financohen nga donatore nderkombetare ose nga burime te pavarura nga qeveria dhe kompanite, si dhe ishin fuqimisht kunder marrjes se ndihmes financiare nga kompanite.

Disa veprimtare kryesore nga qeveria dhe kompanite shprehen mendimin se perfaqesimi i shoqerise civile nuk e paraqit si duhet kete grup interesi dhe se duhet zgjeruar.

Vleresimi i Validuesit

Ka patur perfshirje te shoqerise civile ne procesin EITI, mirepo qellimi i zgjerimit dhe perpjekjet e ndermarra deri tani nga Grupi i Punes nuk kane arritur rezultatin “qe shoqeria civile te jete e angazhuar ne menyre aktive si pjesemarrese ne projektimin, vrojtimin dhe vleresimin e procesit, dhe qe ajo te kontribuojte ne debatin publik”, per te cilin “zbatimi i EITI ka nevojte ta angazhoje gjeresisht shoqerine civile, ose nepermjet Grupit te veprimtareve kryesore, ose perveç ketij grupi ne forma te tjera”(Udhezuesi i Validimit EITI). Vete shoqeria civile ne Shqiperi eshte disi e fragmentuar dhe organizimi i saj eshte ende relativisht i papjekur. Prandaj dhe pjesemarrja ne EITI dhe rritja e pjesemarrjes se saj eshte veçanerisht e rendesishme.

Gjeresia e angazhimit të shoqërisë civile ka qenë e kufizuar për pjesën më të madhe të kohës që kur Shqipëria aderoi në EITI. Shoqëria civile ka qenë e përfaqësuar nga vetëm një sektor-sektori jo-qeveritar dhe madje edhe ky angazhim ka qenë shumë i kufizuar (Nuk ka patur përfaqësim në Grupin e Punes nga pjesë të tjera të shoqërisë civile, për shembull nga grupet e komunitetit, nga organizata fetare, nga shoqata profesionale, nga sindikata ose grupe avokatie). Numri maksimal i grupeve të shoqërisë civile, të angazhuara në eventet EITI është 11. Megjithatë, vetëm një organizatë ka marrë pjesë në mbledhjet e Grupit të Punes pak a shumë rregullisht, ndërsa dy organizata të tjera kanë ndjekur disa nga takimet, ndërkohë që nuk ka prova që pesë organizatat e tjera (nga të tjerat organizatat fillestare që iu përgjigjen ftesës së qeverisë për t'iu bashkuar EITI) të kenë patur ndonjë përfshirje në procesin EITI. Nuk ka prova që qeveria ose Grupi i Punes planifikojnë të angazhojnë edhe më tepër shoqëri të civile në nivelin e Grupit të Punes ose qeverisë. Ka patur përpjekje nga anëtarë individualë të Grupit të Punes (sikurse themelimi i një rrjeti lokal EITI, i përshkruar më sipër): këto kanë qenë nisma të vete OJF-ve.

Në nuk gjetem ndonjë provë të aksesit të Grupit të Punes në grupet më të gjera të shoqërisë civile. Nuk ka rregullime për të informuar shoqëri të civile me në gjerësi të saj, në mënyrë sistematike dhe mbi baza të rregullta për EITI, sikurse janë faqet e internetit, buletinet, përditësimet e më rradhë (burimi kryesor elektronik për informacion për EITI është faqja e internetit e Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës, e cila përmban një seksion për EITI si në shqip dhe në anglisht (www.mete.gov.al)). Sipas Sekretariatit, një faqe e re interneti, e dedikuar në mënyrë specifike për EITI do të lansohet në të ardhmen e afert, por në kohën e shkrimit të këtij raporti, faqja e re e internetit nuk është vepruare. Faqja e sotme vepruare nuk jep emrat e përfaqësuesve të shoqërisë civile në Grupin e Punes, madje as nuk përmban materiale të projektuara veçanërisht për shoqëri të civile). Nuk ka publikime, të printuara ose elektronike, të cilat do të synonin në mënyrë specifike shoqëri të civile. Shoqëria civile mori pjesë në vetëm një event mediatik, në prill 2011. Si rezultat, niveli i ndergjegjesimit të shoqërisë civile për EITI është i ulët. Disa OJF të mëdha në fushën e transparencës dhe mbrojtjes së konsumatorit u kontaktuan gjatë Validimit. Ata pretenduan se nuk kanë informacion lidhur me EITI, por shprehën interes për të marrë pjesë, kur u informuan nga Validuesi.

Nuk ka prova të mjaftueshme të veprimeve për të ndërqur kufizimet e kapacitetit që pengojnë pjesëmarrjen e shoqërisë civile, të ndermarra nga qeveria, shoqëria civile apo kompanitë. Përpjekje të tilla ose u ndermorren nga të tjerë partnerë, ose përfshinë një numër të vogël të përfaqësuesve të shoqërisë civile. Vetëm një OJF mori pjesë në takimin e Grupit të Punes në shtator 2009, ku Sekretariati Ndërkombëtar i EITI dha një prezantim për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në EITI. 11 OJF dhe përfaqësues mediash morën pjesë në një workshop gjysëm ditor të organizuar nga Banka Botërore për shoqëri të civile, në shtator 2009. Një përfaqësues i shoqërisë civile mori pjesë në takimin e Grupit të Punes më 10 dhjetor 2009, ku studimi i Bankës Botërore për sektorin e industrisë nxjerrëse në Shqipëri u prezantua dhe ku u shpjeguan amendimet në Ligjin Minerar.

Ky tregues nuk është arritur.

3.7 Treguesi 7 i Grides: A jane kompanite te angazhuara ne proces?

“*Qellimi:* Ky tregues perforcon Treguesin 5. Zbatimi i EITI kerkon qe kompanite te jene te angazhuara ne menyre aktive ne zbatim dhe qe te gjitha kompanite te raportojne sipas EITI. Per te arritur kete, zbatimi i EITI ka nevojte te angazhoje gjeresisht kompanite e naftes, gazit dhe ato minerare. Kjo mund te realizohet nepermjet grupit nderinstitucional, ose pervec grupit te veprimtareve kryesore, me forma te tjera.

Prova: Per te miratuar kete tregues, Validuesi duhet te shohe prova se qeveria dhe grupi i veprimtareve kryesore ishin te duhurit dhe kane synuar te angazhojne kompanite (te naftes, gazit dhe ato minerare) ne procesin e zbatimit te EITI. Kjo duhet te perfshije provat e meposhtme:

- Aksesi nga ana e grupit te veprimtareve kryesore ne kompanite e naftes, gazit dhe ato minerare, duke perfshire komunikimet (mediat, website, letra), duke i informuar ato per angazhimin e qeverise per te zbatuar EITI, si dhe per rolin qendror te kompanive;
- Veprime per te rregulluar limitet e kapaciteteve qe pengojne kompanite, te ndermarra nga qeveria, shoqeria civile ose kompanite”

Progresi deri tani

Pjesemarrja e kompanive ne Grupin e Punes te EITI lejohet nga Urdheri i kryeministrit Nr. 156 date 12 dhjetor 2008. METE ftoi dy kompani te industrise nxjerrrese ne takimin e pare te Grupit te Punes me 17 mars 2009, i cili miratoi planin e punes se vendit. Sipas njerit prej pjesemarrsesve nga kompanite (perfaqesuesi i FIAA), ata qe u ftuan e moren planin e punes me perpara dhe kishin nje mundesi per ta komentuar ate. Sikurse eshte shpjeguar me siper, deri ne prill 2011 nuk kishte perfaqesues te komunitetit te biznesit ne Grupin e Punes, mirepo lista e fundit e anetaresise, e dhene nga Sekretariati me 26 prill 2011 perfshin pese perfaqesues te industrise: dy kompani minerare (Beralb dhe ACR), dy kompani te naftes (Bankers dhe Albpetrol, kompania shteterore), si dhe nje perfaqesues nga Shoqata e Investuesve te Huaj te Shqiperise (FIAA).

Perfaqesuesit e industrise moren pjese ne takimin e Grupit te Punes qe u muar me miratimin e formulareve te raportimit EITI, me perzgjedhjen e administratorit te pavarur dhe me perzgjedhjen e Validuesit.

Perfaqesues te tjere kompanish u ftuan kohe pas kohe ne mbledhjet e Grupit te Punes: gashte kompani moren pjese ne takimin e dates 18 shtator 2009, kur Sekretariati nderkombetar i EITI dha nje prezantim; pese kompani moren pjese ne nje prezantim nga Fair Links per nje studim ne transferimin e çmimit ne sektorin e industrise nxjerrese, me 15 shkurt 2010; gjashte kompani ndoqen prezantimin mbi raportin e rakordimit te pagesave, nga administratori i pavarur me 22 prill 2011.

Nga fundi i vitit 2009, AKBN pergatiti dhe shperndau nje formular raportimi per pagesat e kryera nga kompanite e naftes dhe ato minerare ne 2009-en. Formularet e mbushur nga 95 kompani u mblodhen ne vitin 2010 nga AKBN. Formati u diskutua ne nje takim ne korrik 2009, te ndjekur nga perfaqesuesi i nje kompanie dhe nga dy perfaqesues te shoqerise civile. Sipas Sekretariatit, formulari nuk ishte menduar qe te zevendesonte nje formular zyrtar raportimi te ALBEITI, por sherbente per te testuar vullnetin e kompanive per te marre pjese ne EITI, duke perfshire deklarimin e te ardhurave te tyre. Nuk ka informacion lidhur me menyren se si te dhenat e marra u perdoren, por qeveria e citon kete ushtrim se prove te perfshirjes se kompanive ne EITI.

Seksioni EITI i faqes ne internet te METE permban disa informacione per kompanite, duke perfshire raportimin mbi Urdherin e Kryeministrit per EITI, po ashtu si dhe formularet e raportimit EITI. Dy kompani(nje e naftes dhe nje minerare) publikuan informacion mbi pagesat e tyre ndaj qeverise dhe nivelin e tyre te prodhimit ne faqet e tyre te internetit, njera prej tyre madje publikoi informacion per EITI.

Ne nuk kemi pare prova te qeverise te perpjekjeve te saj per te patur akses ne komunitetin me te gjere te biznesit dhe gjetem nje ndergjegjesim ne teresi te ulet per EITI mes kompanive qe takuam. Perfaqesuesit e qeverise citojne legjislacionin qe i mandaton kompanite minerare te japin te dhena si nje shembull te perkushtimit te qeverise ne EITI, por legjislacioni nuk eshte prove e dialogut me kompanite, ndjesi te pronesise se nismes nepermjet rritjes se ndergjegjesimit dhe perpjekjeve per informim, te mbeshtetura nga qeveria.

Pikepamjet e veprimtareve kryesore

Perfaqesuesit e qeverise dhe te shoqerise civile ne Grupin e Punes jane plotesisht te kenaqur me angazhimin e kompanive dhe nuk presin ndonje angazhim me teper. Perfaqesuesit e shoqerise civile ne Grupin e Punes nuk deshironin te pranonin ndonje asistence financiare nga kompanite per te shtuar aktivitetet e tyre ne berjen publike te EITI ne Shqiperi.

Ndergjegjesimi per Grupin e Punes ALBEITI, per qellimin dhe aktivitetet e tij ishte i ulet mes kompanive.

Per te ilustruar nivelin e ndergjegjesimit, po japim disa detaje mbi diskutimet me tre kompani te medha prodhuese. Ne i kerkuam Sekretariatit ALBEITI te na rregullonte takime me kompani te industrise nxjerrese, per te diskutuar me to per EITI dhe ushtrimin e raportit te rakordimit EITI. Perfaqesuesi i kompanise me te madhe prodhuese te kromit, ACR nuk ishte ne dijeni te EITI. Ne takuam nje perfaqesues te dyte te kompanise, i cili kishte dhene informacion per rakordimin, por qe nuk e kuptonte EITI dhe aresyet pse mblidheshin te dhenat.

Ne takuam perfaqesues te larte nga te dy prodhuesit e naftes. Bankers Petroleum erdhen ne nje takim ne METE ne prill 2010, por nuk kishin degjuar asgje me shume per EITI, derisa atyre iu kerkuua te mbushnin formularet. Nga kompania Stream Oil and Gas na thane se degjuan per nismen kur u kontaktuan nga rakorduesi. Asnje nga kompanite nuk dinte gje per perberjen ose funksionet e Grupit te Punes ALBEITI, ose te qellimit te rakordimit EITI, por nuk paten veshtiresi ne dhenien e informacionit te kerkuar, pse, sikurse thane ata, ai ishte tashme ne faqet e internetit te kompanive perkatese.

Ne po ashtu takuam dy perfaqesues te Albpetrol, te cilet moren pjese ne takimin e Grupit te Punes, ku u prezantua drafti i raportit te rakordimit te pagesave. Ata thane se kishin ardhur te konfirmonin te dhenat e perfshira ne raport per AlbPetrol, edhe pse ata nuk ishin perfshire ne plotesimin e formulareve dhe nuk kishin dijeni per EITI. Ai ishte takimi i pare i Grupit te Punes qe ata po ndiqnin dhe deklaruan se e votuan raportin e paraqitur ne takim.

Ne teresi, kompanite e konsultuara gjate Validimit nuk shprehen ndonje pakenaqesi me nivelin e perkushtimit te qeverise, por nuk mund te citonin ndonje shembull te perpjekjeve te qeverise per te angazhuar kompanite pertej kerkeses per te dorezuar te dhena per raportin e rakordimit te pagesave. Kompanite shprehen mbeshetjeten e tyre ndaj EITI me besimin se duhet te kishte me shume transparence ne vend. Disa kompani besojne se pjesemarrja e tyre mund te jete me aktive, por nuk kane ide se si mund te kontribuojne ne EITI.

Vleresimi i Validuesit

Ne u takuam si me kompanite private prodhuese te naftes dhe me kompanine shteterore, si dhe me shume kompani minerare(shiko Shtojcen 1 per listen e plote te te intervistuarve).

Raporti i rakordimit deklaroi se 9 kompani nafte dhe 37 kompani minerare u perfshine ne ushtrim dhe qe pergjigjet u moren nga te gjitha kompanite e naftes dhe nga 32 kompani minerare. Raporti thote po ashtu se kompanite qe nuk u pergjigjen kishin aktivitet te kufizuar(te papercaktuar). Duke patur parasysh kohen e shkurter per mbledhjen e te dhenave, niveli i arritur i pergjigjeve te marra eshte shenje e vullnetit te kompanive per te qene ne perputhje me kerkesat e

raportimit EITI ne nje vit raportimi kur nuk ishte detyruese per ta bere kete(ligji qe u kerkon kompanive minerare te pershtaten u pergatit dhe hyri ne fuqi ne vitin 2010).

Ne kendveshtrimet e tjera, angazhimi nga ose me kompanite per EITI ka qene i kufizuar. Rregullat e EITI dhe Udhezuesi i Validimit kerkojne nga Validuesi te shohe prova te shtrirjes nga ana e Grupit te veprimtareve kryesore ne kompanite e naftes, gazit dhe ato minerare, duke perfshire komunikimet(mediat, website, letra), duke i informuar ato per angazhimin e qeverise per te zbatuar EITI, si dhe per rolin qendror te kompanive, si dhe prova te veprimeve per te rregulluar limitet e kapaciteteve qe pengojne kompanite, te ndermarra keto nga qeveria, shoqeria civile ose kompanite. Pak eshte bere ne te dy keto fusha. Te dyja broshurat mbi burimet hidrokarbure dhe minerare te Shqiperise, te adresuara per investuesit e huaj dhe te publikuara nga Agjensia Kombetare e Burimeve Natyrore ne vitin 2010, nuk e permendin EITI-n. Nuk ka prova te komunikimeve dhe te publikimeve , te projektuara per te promovuar pjesemarrjen e kompanive ne EITI(Vetem kohet e fundit Sekretariati nisi perpjekjet e tij per t'u shtrire tek industria dhe pati nje interviste te Drejtuesit te Sekretariatit lidhur me EITI, te publikuar ne gazeten "Metropol" dhe te pergatitur per komunitetin e biznesit, me 21 prill 2011). Grupi i Punes nuk ka ndonje plan specifik per te angazhuar kompanite ne EITI. Nuk ka prova te perfaqesuesve te industrise ne Grupin e Punes qe te komunikojne me kompanite e tjera(faqja e internetit e Shoqates se Investuesve te Huaj ne Shqiperi(www.fiaa.com) jep perditese periodike mbi aktivitetet e Shoqates, por nuk ka permendje te EITI, edhe pse nje perfaqesues i FIAA ne fakt eshte anetar i Grupit t e Punes). Niveli i ndergjegjesimit lidhur me EITI, i kompanive te kontaktuara gjate Validimit eshte shume i ulet, madje edhe mes drejtuesve te larte. Disa drejtues te larte madje edhe nuk dinin gje per pjesemarrjen e kompanive te tyre ne kete proces(Kjo, pervec konfuzionit lidhur me perfaqesimin e kompanive ne Grupin e Punes, sikurse eshte pershkruar ne treguesin S). Ne te njejten menyre, kompanite ishin teresisht te pandergjegjesuara per kontributin e tyre te mundshem ne EITI, pervec kerkeses per te raportuar, te tille si zhvillimi i kapaciteteve per shoqerine civile, informimin dhe fushatat ndergjegjesuese, ndihmen financiare dhe te tjera.

Per me teper, pjesemarrja e kompanive ne Grupin e Punes ka qene e ulet, ne ate qe nuk ka patur perfaqesim kompanish ne pjesen me te madhe te takimeve. Nga kater takime ne vitin 2009, ato ndoqen tre(nuk pati perfaqesim me 10 dhjetor 2009), nga tete takime ne vitin 2010, perfaqesuesit e industrise ndoqen vetem nje(nuk pati perfaqesim me 8 prill 2010, 17 qershor 2010, 14 shtator 2010, 23 nentor 2010, 24 nentor 2010, 25 nentor 2010 dhe 30 nentor 2010). Ne vitin 2011, kompanite nuk ishin te pranishme ne nje takim me 12 prill.

Keshtu, nga njera ane kishte perputhje te aresyeshme me raportimin EITI. Nga ana tjetere, ndergjegjesimi i pergjithshem i qellimeve te EITI dhe angazhimi me shoqerine civile dhe me qeverine ne Grupin e veprimtareve kryesore ka qene ne nivel te ulet.

Pjesemarrja e kompanive ne raportimin EITI eshte nje element thelbesor per suksesin e programit dhe kishte perputhje te mire per raportin 2009 ne Shqiperi. Nuk eshte, megjithate, e

gjithë historia e angazhimit dhe është e qarte që komunikimi nga dhe me kompanite për zbatimin e EITI ka qenë i papershtatshëm-nga qeveria, nga Grupi i Punës dhe nga të gjithë veprimtarët kryesorë të tij, si dhe nga vetë kompanite. Ndertimi i kapaciteteve, aktivitetet e komunikimit dhe angazhimi me i gjere mes kompanive dhe shoqërisë civile, të gjitha këto kanë nevojë të përmiresohen.

Me këto rezerva dhe duke patur parasysh rekomandimet e bëra në seksionin 5.2.6, në konsiderojmë që ky tregues është arritur.

3.8 Treguesi 8 i Grides: A hoqi Qeveria ndonjë pengesë në zbatimin e EITI?

“Qellimi: Aty ku ka pengesa ligjore, rregullatore ose të tjera për zbatimin e EITI, do të jetë e nevojshme për qeverinë t’i heqë këto pengesa. Pengesa të zakonshme përfshijnë klauzola konfidencialiteti në kontrata të qeverisë dhe kompanive, si dhe falje konfliktuese departamentesh qeveritare.

Prova: Për të miratuar këto tregues, Validuesi duhet të shohë prova se qeveria i ka hequr të gjitha pengesat. Kjo mund të përfshijë ndjekjen e një vlerësimi proaktiv të pengesave, ose nëpërmjet veprimit kundërveprues, duke i hequr pengesat sa herë ato dalin. Nuk ka një mënyrë të vetme të trajtimit të kesaj çështjeje-vendet do të kenë kuadër ligjore të ndryshëm dhe marrëveshje të tjera që mund të pengojnë zbatimin, si dhe do t’u duhet t’i përgjigjen kesaj në mënyrë të ndryshme. Lloji i provës që Validuesi mund të dojë të shikojë mund të përfshijë:

- Një shqyrtim të kuadrit ligjor;
- Një shqyrtim të kuadrit rregullator;
- Një vlerësim të pengesave në kuadrin ligjor dhe rregullator, të cilat mund të pengojnë zbatimin e EITI;
- Ndryshime të propozuara ose të kryera ligjore dhe rregullatore, të projektuara për të vënë në funksionim transparencën;
- Heqje dore e klauzolave konfidenciale në kontratat ndërmjet qeverisë dhe kompanive, për të lejuar dhenien (berjen publike) e të ardhurave;
- Komunikimet e drejtperdrejta, për shembull me kompanite, që lejojnë transparencë me të madhe;

- Memorandum Mirekuptimi qe vendos standarde dhe prtishmeri transparence te rena dakort mes qeverise dhe kompanive”.

Progresi deri tani

Nuk kemi pare ndonje vleresim zyrtar nga ose per llogari te Grupit te Punes mbi pengesat ligjore dhe rregullatore ndaj zbatimit te EITI ne Shqiperi. METE pergatiti ne vitin 2009 amendamente te ligjit Minerar te vitit 1994, te cilat u kaluan si ligj ne Parlament ne vitin 2010(nuk ka prova te perfshirjes se kompanive ose te shoqerise civile ne rishikimin ligjor dhe rregullator, ose ne pergatitjen e amendamenteve ligjore). Ligji i ri Minerar (Nr. 10304 date 15 korrik 2010) e beri raportimin EITI te detyrueshem per kompanite minerare. Ne menyre specifike, Neni 36 i ketij Ligji thote:

Ne kuadrin e nismes se Transparences ne Industrine Nxjerrrese, persona subjekte te ketij ligji duhet:

- a) te raportojne ne perputhje me kerkesat e permbajtura ne aktet nenligjore te pergatitura brenda detyrimeve te specifikuar ne EITI;
- b) çdo raport teknik, financiar ose pagesa taksash duhet te jete ne perputhje me praktikat me te mira nderkombetare per industrine nxjerrrese;
- c) aktivitetet minerare te subjekteve minerare ne Shqiperi dhe veprimet e tyre financiare me kompani mema ose bija jashte shtetit, duhet te kryhen ne perputhje me kostot ose me nje perfitim te aresyeshem te identifikuar ne programet e aktiviteve te tyre minerare.

Ne vijim te ketij Ligji, Kabineti leshoi nje Vendim me 23 mars 2011, duke i detyruar kompanite minerare te dorezojne raporte çdo gjashte muaj, ne perputhje me formularet e aprovuar te EITI.

Sipas METE, keto ndryshime legjislative dhe rregullatore i hoqen te gjitha pengesat zbatimit te EITI. Nuk ka plane per te amenduar Ligjin e Naftes(Zbulimi dhe Prodhimi) Nr. 7746 date 28 korrik 1993, ose akte te tjera ligjore dhe rregullatore qe lidhen me industrine e naftes dhe gazit. Sipas METE, çeshtja e konfidencialitetit eshte trajtuar me nje heqje dore nga konfidencialiteti, te perfshire ne formularet EITI. Me te vertete, te nende kompanite e kerkuara per te dorezuar deklaratat e tyre per raportin 2009 te EITI, ishin ne perputhje me kete kerkese.

Pikepamjet e veprimtareve kryesore

Te gjithe veprimtaret kryesore te kontaktuar gjate Validimit, si brenda dhe jashte Grupit te Punes, rane dakort se nuk ka pengesa ligjore dhe rregullatore ndaj zbatimit te EITI.

Vleresimi i Validuesit

Qeveria shpjegoi se nuk ishte bere ndonje amendim Ligjit te Naftes, sepse kishte kontrata ekzistuese dypaleshe me kompani naftes qe nuk mund te ndryshoheshin. Megjithate ne kemi rekomanduar qe legjislacioni qe aplikohet mbi kompanite e naftes te rishikohet.

Ne linje me çeshtjen e ngritur nga draft-Raporti i Validimit, Grupi i Punes miratoi nje formular per nje Memorandum Mirekuptimi mes Sekretariatit ALBEITI dhe kompanive te naftes. Sekretariati ALBEITI planifikon ta kete kete Memorandum te nenshkruar me 30 shtator 2011. Ligji Minerar u amendua gjate vitit 2010 per t'u perputhur me raportimin EITI, edhe pse amendimi nuk ishte efektiv persa i perket vitit 2009.

Raportimi i kompanive per rakordimin 2009, ku 41 nga 46 kompani u pergjigjen, ishte mbi baza vullnetare dhe mungesa e legjislacionin nuk perbente nje pengese.

Ky tregues eshte arritur.

3.9 Treguesi 9 i Grides: A jane miratuar formatet e raportimit?

“Qellimi: Formularet e raportimit jane thelbesore ne procesin e deklarimit dhe rakordimit te te dhenave, si dhe per prodhimin e raportit final te EITI. Formularet do te percaktojne se cilat nivele(flukse) te ardhurash jane perfshire ne deklarimet e kompanive dhe te qeverise. Formularet duhet te miratohen nga Grupi i veprimtareve kryesore. Kriteri EITI kerkon qe “te gjitha pagesat materiale te naftes, gazit dhe ato minerare te bera qeverise dhe te gjitha te ardhurat te marra nga qeveria prej kompanive te naftes, gazit dhe ato minerare” te publikohen. Prandaj dhe formularet EITI duhet te percaktojne me miratim nga Grupi i veprimtareve kryesore se cilat pagesa materiale dhe te ardhura do te perfshijne, si dhe çfare perben “material”. Do te jete po ashtu e nevojshme per Grupin e veprimtareve kryesore te percaktoje periudhat kohore te mbuluara nga raportimi. Nje fluks te ardhurash eshte material(kryesor) nese heqja ose deklarimi i gabuar i tij do te ndikonte ne raportin final te EITI. Njihet ne teresi se fluksset e meposhtme te te ardhurave duhet te perfshihen:

- Titulli i prodhimit i qeverise mikpritese(te kompanise nxjerrese-shen i perkth.)
- Titulli i prodhimit i kompanise kombetare shteterore;
- Taksat mbi fitimin;

- Ruajalitetet(rentat minerare);
- Dividendet;
- Bonuset(te tille si i nenshkrimet, i zbulimit, i prodhimit);
- Pagesat per licencen, per renten, pagesa hyrjeje dhe konsiderime te tjera per licencat dhe/ose koncesionet;
- Nafta perfituese;
- Perfitime te tjera domethenese ndaj qeverise, te miratuara nga Grupi i veprimtareve kryesore.

Prova: Per te miratuar kete tregues, Validuesi duhet te shohe prova se Grupi i veprimtareve kryesore eshte konsultuar ne pergatitjen e formulareve , qe grupe te gjera te interesit kane patur mundesine te komentojne, si dhe qe Grupi i veprimtareve kryesore i ka miratuar formularet perfundimtare. Kjo mund te perfshije provat e meposhtme:

- Draft formularet e dhene Grupit te veprimtareve kryesore;
- Minutat e takimit te Grupit te veprimtareve kryesore per diskutimet mbi formularin;
- Komunikimet ne nivele me te gjera te veprimtareve kryesore(p.sh., kompanite) lidhur me projektimin(dizajnin) e formulareve;
- Rregullim per te aftesuar veprimtaret kryesore te kuptojne çeshtjet e perfshira;
- Nje deklaratë nga Grupi i veprimtareve kryesore qe ata i miratuan formularet, duke futur te gjitha nivelet e te ardhurave per t'u perfshire”.

Progresi deri tani

Ka patur, sikurse e kuptuan nga perfaqesuesit e qeverise, diskutime lidhur me nivelet e te ardhurave per t'u perfshire ne Raportin e Pare EITI te Rakordimit te Shqiperise ne fillim te vitit 2010 dhe draft formularet u pergatiten pas konsultimit me nje numer kompanish. . Formati u konsiderua ne nje takim ne korrik 2009, te ndjekur nga nje perfaqesues kompanie dhe nga dy perfaqesues te shoqerise civile. Formularet ju shperndane kompanive per plotesim nga AKBN dhe keta formulare te plotesuar ju rikthyen AKBN-se. Ne kuptojme se asgje me shume nuk eshte bere me informimin dhe nuk u ndermor rakordim.

Pas caktimit të një Rakorduesi, Grupi i Punes u takua më 11 mars 2011 dhe konsideroi flukset financiare për t'u përfshirë në Raportin e Rakordimit të Pagesave për 2009-en. Takimi miratoi flukset dhe formën e formulareve që duhen përdorur për t'i mbledhur ato. Forma e formulareve të përdorura për rakordimin e 2009-es u kërkua nga Grupi i Punes që të ishte në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me kërkesat e EITI. Formularet u diskutuan në Grupin e Punes, por nuk iu qarkulluan paleve jashtë Grupit të Punes.

Të gjitha kompanitë e naftës aktive në Shqipëri në 2009 (si në prodhim dhe në zbulim) dhe ato kompani minerare, prodhimi i të cilave i kalonte kufijtë e treguar më poshtë, u përfshinë në Rakordimin 2009. Kufijtë ishin:

Krom	2,000 ton në vit
Baker	114,000 ton në vit mineral i nxjerre
Nikel	5,000 tone në vit.

Perveç kësaj, kompanitë minerare ndërkombëtare në zbulim u përfshinë.

Termet e References për Validuesin thënë se raporti duhet të përfshijë kompanitë minerare që mbulojnë 60% të nxjerrjes së mineralit në Shqipëri (45-50 kompani) dhe 90% të prodhimit të naftës bruto (2 kompani). Kufizimi në numrin e kompanive që duhet të përfshiheshin ishte për shkak të një kombinimi të kohës në dispozicion për ta prodhuar raportin (sipas afatit të validimit) dhe strukturës së industrisë minerare (me shumë prodhues të vegjël), por nuk është e përshtatshme për një raport të parë EITI.

Perzgjedhja e kompanive minerare u bazua në prodhimin e raportuar. Në diskutim me Grupin e Punes nëse duhet që përcaktimi i kompanive për t'u përfshirë në raportet e ardhshme të bazohet në ekzaminimin e niveleve të të ardhurave që mërr qeveria nga sektori dhe sugjeruam që ata duhet të konsiderojnë që të kryejnë një studim të plotë tematik lidhur me flukset financiare. Në përfshirë rekomandimet për këtë në seksionin 5.2.7. Lista kohore për kryerjen dhe plotësimin e rakordimit ishte 5 javë nga data e fillimit dhe subjektet e raportuesve ju dha një javë nga data e marrjes së formulareve, që t'ia kthenin formularet e plotësuar Rakorduesit.

Pikepamjet e veprimtareve kryesore

Anetaret e konsultuar të Grupit të Punes shprehën pikepamjen që ka patur diskutime të përshtatshme mbi qëllimin e rakordimit, në lidhje me nivelet e të ardhurave për t'u përfshirë, me kompanitë që kryenin pagesa materiale (të rendesishme) dhe në lidhje me formën e formulareve që do të përdreshin për të mbledhur të dhënat.

Kompanitë shprehën opinionin se pagesat e tjera duhet të përfshiheshin, duke përmendur pagesat për përgjegjësinë shoqërore korporative, taksa e të ardhurës e mbledhur prej punonjësve për

qeverine, si dhe TVSH. U njoh se koha per pergatitjen e rakordimit 2009 ishte shume e shkurter dhe se duhet te kete nje limit mbi sferen e pagesave te perfshira, nderkohe qe sigurohet se minimumi i kerkesave te EITI eshte plotesuar, me qellimin qe te konsiderohet zgjerimi i sferes ne te ardhmen.

Vleresimi i Validuesit

Pati diskutime te pershtatshme dhe kuptim mes anetareve te Grupit te Punes per sferen e pagesave, metodologjine, rakordimin dhe miratim te formulareve dhe te shenimeve udhezuese.

Lista kohe e shkurter per rakordimin, e detyruar te ishte keshtu nga afati i afert i Validimit, duket se e ka kufizuar sferen e pagesave te kompanive te cilat ishin perfshire, sikurse eshte referuar me siper. Raporti i rakordimit komenton se ne dhenien e rekomandimeve per sferen e flukseve te perfitimeve dhe per kompanite qe duhet te konsiderohen, vemendja duhet te ndalet ne afatin shume te shkurter me te cilin EITI Shqiperi per raportin EITI 2009. Ne vume re se vetem pagesat ndaj qeverise qendrore ishin perfshire. Ky vendim u be ne baze te konsiderimit nga Grupi i Punes i analizes se kryer nga Sekretariati per pagesat e sektorit te industrise nxjerrese, i cili percaktoi se pagesat kryesore nga kompanite nxjerrese ishin rentat(ruajalitetet) minerare, taksat e fitimit te korporates dhe komisionet mbi siperfaqen; si dhe shtesa e bonuseve te nenshkrimet dhe e pagesave nga AlbPetrol.

Megjithate, kufizimi i sferes per shkaqe te te qenit praktik nuk duket se ka çuar ne heqjen ne rakordimin 2009 te ndonje pagese materiale nga kompanite nxjerrese per qeverine, as edhe te heqjes se ndonje te ardhure materiale te marre nga qeveria prej kompanive nxjerrese. Formulari i miratuar nga Grupi i Punes permban nje seksion per kompanite per te perfshire “pagesa te tjera domethenese per Shtetin”, te cilin kompanite mund ta mbushnin mbi baza vullnetare. Rakorduesi raporton se kompanite nuk deklaruan ndonje perfitim domethenes pertej pagesave dhe perfitimeve te percaktuara.

Ky tregues eshte arritur.

3.10.Treguesi 10 i Grides: A eshte i kenaqur Grupi i Veprimtareve kryesore me organizaten e caktuar per te rakorduar shifrat?

“*Qellimi:* Nje organizate duhet caktuar per te marre te shifrat e zbuluara te kompanive dhe te qeverise, per t’i rakorduar keto shifra dhe per te prodhuar raportin perfundimtar EITI. Kjo organizate njihet ndryshe edhe ssi administratore, rakorduese ose auditore. Eshte jetesore qe ky rol te permbushet nga nje organizate qe shikohet nga veprimtaret kryesore si e besueshme, me autoritet dhe teknikisht e afte.

Prova: Per te miratuar kete tregues, Validuesi duhet te shohe prova se Grupi i veprimtareve kryesore eshte i kenaqur me organizaten e caktuar per te rakorduar shifrat. Kjo mund te perfshije provat e meposhtme:

- Termat e References te rena dakort nga Grupi i veprimtareve kryesore;
- Lidhje transparente me sekretariatin e EITI dhe me Bordin, per te identifikuar Validuesit potenciale(te mundshem);
- Renie dakort nga Grupi i veprimtareve kryesore mbi perzgjedhjen finale te organizates”.

Progresi deri tani

Minutat(shenimet) e takimit te dates 23 dhjetor 2010 te Grupit te Punes thone se Koordinatori i porsa caktuar i EITI paraqiti Termat e References per Konsulentin e Administrimit dhe pas nje diskutimi me tej, keto terma u miratuan. Eshte vene re qe Banka Boterore u konsultua.

Korrespondenca nga Banka Boterore dhe EITI, qe miratojne fondin dhe termat e references, u konsiderua nga Grupi i Punes ne mbledhjen e tij te 4 janarit 2011 dhe ne ate te 14 shkurtit 2011. Minutat(shenimet) tregojne se kompania Fair Links u caktua si Rakorduese ne nje takim te mevonshem.

Keto minuta shenojne se 9 anetare moren pjese ne takim, duke i listuar tre prej tyre me emer(zoterinjte Alibali, Mati dhe Aliaj). Sikurse e kemi vene re edhe gjetiu, ne nuk na jane dhene listat e pjesemarrjes per takimet e Grupit te Punes.

Pikepamjet e veprimtareve kryesore

Anetaret e Grupit te Punes te konsultuar, duke perfshire perfaqesuesit e kompanive dhe te shoqerise civile, te gjithë shprehen kenaqesi me percaktimin e Rakorduesit dhe veprimtaret kryesore te tjere nuk shprehen pikepamje negative.

Vleresimi i Validuesit

Ne veme re se ka patur diskutim ne Grupin e Punes lidhur me caktimin e Rakorduesit, sipas shenimeve te takimeve te tij dhe diskutimeve tona me anetaret e tij, si dhe ka patur konsultim me Sekretariatin e EITI dhe me Banken Boterore, si dhe nuk ka patur objeksione brenda dhe jashte Grupit te Punes.

Ky tregues eshte arritur.

3.11. Treguesi 11 i Grides: A ka siguruar Qeveria qe te gjitha kompanite do te raportojne?

“Qellimi: Kriteret e EITI kerkojne qe te gjitha kompanite-publike (te zoteruara nga Shteti), private, te huaja apo vendase- t’i raportojne pagesat qe bejne ndaj qeverise, sipas formulareve te rene dakort, kompanise se caktuar per te rakorduar shifra te deklaruar. Qeverise i duhet te marre te gjitha masat e arsyeshme qe te gjitha kompanite te raportojne. Kjo mund te perfshije perdorimin e marreveshjeve vullnetare, kuader rregullator ose legjislativ. Njihet se mund te kete arsyje te bazuara (edhe pse te jashtezakonshme) qe disa kompani mund te mos raportojne per nje periudhe afatshkurter. Ne kete situatë, qeveria duhet te tregojë se ajo ka marre hapa te duhur qe t’i sjelle keto kompani te raportojne ne nje periudhe afatmesme, si dhe qe keto hapa jane te pranueshme per kompanite e tjera.

Prova: Per te miratuar kete tregues, Validuesi duhet te shohe prova se qe qeveria ka bere nje nga veprimet e meposhtme:

- Ka futur/amenduar legjislacion qe e ben te detyrueshem per kompanite qe te raportojne sipas Kritereve te EITI dhe formulareve te raportimit te rene dakort;
- Ka futur/amenduar kuadrin rregullator te duhur qe e ben te detyrueshem per kompanite qe te raportojne sipas Kritereve te EITI dhe formulareve te raportimit te rene dakort;
- Ka negociuar marreveshje (te tilla si memorandume Mirekuptimi dhe heqje te klauzolave te konfidencialitetit tek marreveshjet me ndarje prodhimi) me te gjitha kompanite, per te siguruar qe ato te raportojne sipas Kritereve te EITI dhe formulareve te raportimit te rene dakort;

- Aty ku kompanite nuk marrin pjese, qeveria ndermerr hapa te njohur ne teresi(nga veprimtaret e tjere kryesore) per te siguruar qe keto kompani te raportojne ne nje date te rene dakort me veprimtaret e tjere kryesore”.

Progresi deri tani

Ligji Minerar u amendua ne vitin 2010, per t’iu kerkuar kompanive te japin informacion per EITI. Nuk ka patur ndryshim te ngjashem tek ligji per kompanite e naftes, ngaqe kuptohet se eshte me e veshtire, per shkak te marreveshjeve kontraktuale te meparshme te qeverise me keto kompani.

Ka patur nje nivel pergjigjeje te aresyeshem te kompanive te perfshira ne rakordim, me 41 nga 46 kompanite qe i kane derguar deklaratat e tyre Rakorduesit, sipas raportit te rakordimit. Te gjitha kompanite e naftes i derguan deklaratat, ndersa rakorduesi komenton, ne lidhje me pese kompanite minerare qe nuk u pergjigjen, se “aktiviteti i ketyre kompanive eshte shume i kufizuar dhe eshte krejtesisht e pamundur qe kontributi i tyre ne te ardhurat e Shtetit te jete domethenes”, edhe pse baza per kete deklarate nuk jepet.

Formulet nga keto pese kompani minerare jane tashme derguar tek Rakorduesi, i cili ka deklaruar me tej se pagesat e tyre kapin me pak se 5 perqind te te ardhurave totale te deklaruar nga Shteti. Kompanite i kthyen formularet e tyre pas afatit per perfshirjen ne raport, i cili nuk mund te vonohej per te futur raportimet e vona(sikurse ndodh shpesh), per shkak te kerkeses mbizoteruese per ta publikuar raportin e rakordimit ne kohe per afatin e Validimit.

Pikepamjet e veprimtareve kryesore

Veprimtaret kryesore te konsultuar thane se metoda, parafrimi i zgjedhur nga Grupi i Punes per raportin 2009 ishte i pershtatshem dhe perfshiu te gjitha kompanite nxjerrese qe veprojne ne Shqiperi. Ato shpjeguan se Grupi i Punes vendosi t’i perfshinte te gjitha kompanite e naftes dhe nje numer te kompanive te medha minerare, sipas kriterit te nivelit te prodhimit, te vendosur nga Grupi i Punes dhe qe te gjitha se bashku, te 36 kompanite minerare u perzgjodhen per ushtrimin e rakordimit. Ky numer, 36 perben vetem 5% te numrit total te kompanive minerare te licensuara(738). Megjithate, veprimtaret kryesore te konsultuar ndjenin se ky numer ishte i pershtatshem, perderisa pjesa me e madhe e aktivitetit minerar ne Shqiperi kryhet nga kompani te vogla.

Vleresimi i Validuesit

Pjesemarrja nga kompanite e perfshira ne rakordim ishte e larte, sidomos duke e konsideruar afatin e shkurter kohor ne te cilin deklaratat e tyre u kryen.

Ne na jane dhene shenimet me dore te takimit te Grupit te Punes qe e miratoi raportin(Shih Shtojcen 6). Nuk dihet se çfare veprimi(nese eshte ndermarre ndonje veprim) u propozua ndaj kompanive qe nuk raportuan.

Ky tregues u arrit.

3.12 Treguesi 12 i Grides: A ka siguruar Qeveria qe raportet e kompanise te jene te bazuara ne llogari te audituara sipas standardeve nderkombetare?

“Qellimi: Kriteret e EITI kerkojne qe te gjitha te dhenat e deklaruar nga kompanite te jene te bazuara ne te dhena te marra nga llogari qe jane audituar me standarde nderkombetare. Ky eshte nje komponent jetesor i zbatimit te EITI.

Prova: Per te miratuar kete tregues, Validuesi duhet te shohe prova qe qeveria ka ndermarre hapa per te siguruar qe te dhenat e sjella nga kompanite jane te audituara me standarde nderkombetare. Kjo mund te perfshije veprimet e meposhtme:

- Qeveria kalon nje ligj qe kerkon qe shifrat t’i nenshtrohen standardeve nderkombetare;
- Qeveria amendon standardet ekzistuese te auditit, per te siguruar qe ato jane ne perputhje me standardet nderkombetare, dhe u kerkon kompanive te veprojne sipas ketyre standardeve;
- Qeveria miraton nje Memorandum Mirekuptimi me te gjitha kompanite, ku kompanite bien dakort te sigurojne se te dhenat e derguara prej tyre jane te standardeve nderkombetare;
- Kompanite ne menyre te vullnetshme zotohen te japin te dhena te standardeve nderkombetare;
- Aty ku kompanite nuk japin te dhena te standardeve nderkombetare, qeveria ka rene dakort per nje plan me kete kompani per te arritur standardet nderkombetare brenda nje afati te caktuar kohor;
- Aty ku te dhenat e derguara per rakordim nuk jane te standardeve te audituara, Grupi eshte i kenaqur me rrugen e rene dakort per ta zgjidhur kete”.

Progresi deri tani

Rakorduesi i kerkoi kompanise me te madhe prodhuese te naftes te prodhoje deklarata te verifikuara nga auditori i tij i jashtem nderkombetar. Ne rastet e te gjitha kompanive te tjera, Grupi i Punes vendosi t'i kerkoje Drejtorit te Pergjithshem te çdo kompanie te firmose nje deklarate(po e citojme) "qe njej percaktimet kontabiliste dhe financiare te flukseve perkatese te perfitimit dhe qe i ka pare ato ne menyre strikte, ne plotesimin e formulareve te atashuar te raportimit". Nuk ka reference per statusin e audituar te shifrave. Secili formular raportimi u kerkua te nenshkruhej dhe vulosej nga Drejtori i Pergjithshem. Te gjitha kompanite, pagesat e raportuara te te cilave u perfshine ne raport i derguan keto deklarata, te nenshkruara si duhet.

Jo qe te gjitha kompanite ne shqiperi kerkojne nje audit te pavarur, edhe pse te gjithave kompanive shpk. dhe sha. u kerkohet te auditohen mbi baza vjetore. Kur kompanite shqiptare te rregjistruara prodhojne llogari te audituara, ato nuk jane domosdoshmerisht te audituara mbi bazen e standardeve nderkombetare, edhe nese si pjese e nje grupi, te dhenat qe ato japin per konsolidim ne grup auditohen nen keto standarde ISA.

Pikepamjet e veprimtareve kryesore

Shqetesimi paresor i veprimtareve kryesore ne Grupin e Punes ishte te sigurohej qe rakordimi te plotesohej perpara se sa afati per Validimin e zbatimit te EITI te skadonte. Brenda ketij afati kohor, kuptohet se ka qene jashte praktikes te merrje deklarata nga kompanite, qe konfirmonin se informacioni ne formularin EITI ishte ne perputhje me llogari te audituara sipas standardeve nderkombetare, me perjashtim te nje kompanie. Kompania e naftes, auditoret e te ciles prodhuan deklaraten e e verifikimit, komentuan se nuk ishte problem ta prodhonin kete deklarate, me perjashtim te faktit qe ishte kerkuar brenda nje jave.

Vleresimi i Validuesit

Nuk ka prova te ndonje diskutimi ne minutat e Grupit te Punes, per te provuar leshtjet qe jane diskutuar perpara mberritjes ne vendimet e tyre, edhe pse kur ne e beme pyetjen me Grupn e Punes, na thane qe kjo çeshtje eshte diskutuar. Grupi i Punes nuk ka plane t'u kerkoje kompanive qe dorezimet e ardhshme te deklaratave te tyre te bazohen ne llogari te mbajtura sipas standardeve nderkombetare. Rakorduesi rekomandoi qe verifikimi i deklarateve te bazuara ne kriteret EITI te behet nje rregull per kompanite kryesore te naftes dhe ato minerare.

Ky tregues nuk eshte arritur.

3.13 Treguesi 13 i Grides: A ka siguruar qeveria qe raportimet qeveritare jane

te bazuara ne llogari te audituara mbi standarde nderkombetare?

“*Qellimi:* Kriteret e EITI kerkojne qe te gjitha te dhenat e deklaruar nga qeveria te jene te audituara sipas standardeve nderkombetare.

Prova: Per te miratuar kete tregues, Validuesi duhet te shohe prova qe qeveria ka ndermarre hapa per te siguruar qe te dhenat e sjella nga kompanite shteterore jane te audituara me standarde nderkombetare. Kjo mund te perfshije veprimet e meposhtme:

- Qeveria kalon nje ligj qe kerkon qe shifrat t’i nenshtrohen standardeve nderkombetare;
- Qeveria amendon standardet ekzistuese te auditit, per te siguruar qe ato jane ne perputhje me standardet nderkombetare dhe siguron perputhje me to;
- Aty ku te dhenat e derguara per rakordim nuk jane te standardeve te audituara, Grupi i veprimtareve kryesore eshte i kenaqur me rrugen e rene dakort per ta zgjidhur kete”.

Progresi deri tani

Sipas ligjit shqiptar, auditit i proceseve dhe raportimit qeveritar duhet te kryhet sipas standardeve INTOSAI. Nuk ka legjislacion qe te kerkoje qe te dhenat EITI te deklaruar nga qeveria te auditohen sipas standardeve nderkombetare.

Formulet e miratuar nga Grupi i Punes per mbledhjen e te dhenave nga qeveria nuk jane kerkuar te certifikohen si te bazuara ne llogari te audituara sipas standardeve nderkombetare.

Rakorduesi ka thene se te gjitha deklaratat shteterore te marra nga ai ishin perfaqesuar dhe nenshkruar nga Drejtori i pergjithshem i seciles agjensi shteterore mbledhjeje (Drejtori i Pergjithshem i Taksave, Drejtori i Pergjithshem i Doganave, Drejtori i Pergjithshem i AKBN; Drejtori i Pergjithshem i METE). Pervec kesaj, eshte siguruar nga qeveria nje leter perfaqesimi (nenshkruar nga zvMinistri i METE), qe flet per ceshtje te ndryshme, ne veçanti per cilesine dhe besueshmerine e te dhenave te deklaruar nga Shteti.

Pikepamjet e veprimtareve kryesore

Gjate nje diskutimi te gjate me Grupin e Punes per kete ceshtje, ku ne paraqitem gjetjet tona fillestare, perfaqesuesit qeveritare shpjeguan qartazi proceset e auditit qe aplikohen brenda qeverise. Megjithate, nuk kishte vleresim per kerkesen qe Grupi i Punes duhet te siguroje qe te

dhenat e dorezuara Rakorduesit nga institucionet qeveritare per perfshirje ne raportin EITI duhet te bazohen ne llogari te audituara sipas standardeve nderkombetare. Anetaret e Grupit te Punes ishin te kenaqur qe ka procedura auditimi ne kompanite shtetore dhe qe formularet EITI jane te shoqeruar nga deklarata prej Drejtoreve te Pergjithshem perkates, njelloj si formularet e dorezuara nga kompanite private.

Vleresimi i Validuesit

Nuk ka diskutim ne shenimet e Grupit te Punes lidhur me procedurat per te marre konfirmim per deklaratat EITI te qeverise dhe per marrredhenien e tyre me ndonje audit te shifrave qeveritare, si dhe ne diskutimin tone me Grupin e Punes, nuk kishte vleresim te nevojtes per ta trajtuar kete çeshtje. Termat e References per Rakorduesin nuk permbajne reference per kete pike.

Letra e perfaqesimit e ZvMinistrit jep siguri shtese, duke konfirmuar se te dhenat e sjella nga qeveria jane “te sakta dhe paraqesin si duhet te ardhurat e mbledhura nga Shteti”.

Rregullat e reja EITI sugjerojne se aty ku shifrat qeveritare qe jepen per EITI nuk jane te audituara, sikurse eshte rasti ne Shqiperi, Grupi i Punes duhet te jete i kenaqur me menyren se si kjo çeshtje eshte trajtuar, per shembull, duke kerkuar nje plan me afat kohor per ta futur kete kerkese.

Duke ndjekur diskutimin gjate Validimit, Grupi i Punes po e konsideron kete me tej dhe po kerkon qe departamentet qeveritare te marrin konfirmim auditi ne te ardhmen per deklaratat e tyre EITI.

Ky tregues nuk eshte arritur.

3.14 Treguesi 14 i Grides: A iu dhane te gjitha pagesat materiale te naftes, gazit dhe mineraleve qe kompanite i bejne Qeverise, organizates se kontraktuar per te rakorduar shifrat dhe per te prodhuar Raportin EITI?

Progresi deri tani

Pagesat per t’u perfshire ne sferen e rakordimit u konsideruan nga Grupi i Punes dhe nje vendim perfundimtar u muar nga Grupi i Punes, pas diskutimeve me Rakorduesin dhe nje analize te “materialitetit(pra, te pagesave kryesore)” te kryer nga Sekretariati EITI i Shqiperise. Raporti i rakordimit shenon se te gjitha kompanite e perfshira ne sferen e kthyen deklarimet e mbushura, me

perjashtim te pese kompanive minerare, aktiviteti i te cilave eshte deklaruar te jete shume i kufizuar dhe kontributi i te cilave ne te ardhurat shteterore eshte larg se qenit domethenes.

Formulet nga keto pese kompani minerare jane tashme derguar tek Rakorduesi, i cili ka deklaruar me tej se pagesat e tyre kapin me pak se 5 perqind te te ardhurave totale te deklaruar nga Shteti. Kompanite i kthyen formularet e tyre pas afatit per perfshirjen ne raport, i cili nuk mund te vonohet per te futur raportimet e vona(sikurse ndodh shpesh), per shkak te kerkeses mbizoteruese per ta publikuar raportin e rakordimit ne kohe per afatin e Validimit.

Pikepamjet e veprimtareve kryesore

Bazuar ne raportin e Rakordimit, veprimtaret kryesore besojne se te gjitha pagesat materiale(kryesore) jane deklaruar dhe ata e miratuan raportin me daten 4 maj.

Vleresimi i Validuesit

Flukset e perfitimit material u percaktuan nga Grupi i Punes, por nuk ka percaktim se cila mase e pageses eshte materiale, as edhe se cila diference mes shifrave te kompanive dhe atyre te qeverise duhet konsideruar materiale(kryesore).

Shifrat e kompanive, me perjashtim te atyre nga Bankers Petroleum, nuk jane konfirmuar ne menyre te pavarur dhe ka diferenca ndermjet pagesave te raportuara nga kompanite dhe arketimeve te raportuara nga qeveria. Ne mungese te nje percaktimi mbi “materialitetin”(te qenit kryesor), te gjitha pagesat dhe diferencat duhen konsideruar si materiale, keshtu qe nuk eshte e mundur te perfundosh se te gjitha pagesat materiale i jane raportuar Rakorduesit.

Ky tregues nuk eshte arritur.

3.15 Treguesi 15 i Grides: A iu dhane te gjitha te ardhurat e naftes, gazit dhe

mineraleve te arketuara nga Qeveria(“te ardhurat”) organizates se

kontraktuar per te rakorduar shifrat dhe per te prodhuar Raportin EITI?

Progresi deri tani

Progresi i bere ne kete fushe eshte vendosur nen Treguesin 14.

Ka mosrakordime te pazgjidhura te treguara ne raportin e rakordimit, per shume nga flukset ne menyre individuale. Me domethenesja e ketyre mosrakordimeve ngrihet ne lidhje me renten e deklaruar nga kompanite e naftes(8.828 milion dollare amerikane) dhe arketimet e rentes nga sektori i naftes, te deklaruar nga qeveria(8.175 milion dollare), nje mosrakordim qe shkon ne 0.65 milion dollare. Kjo perfaqeson 7.8 perqind te arketimeve totale prej sektorit te naftes, te deklaruar nga qeveria, duke perjashtuar levizjet me AlbPetrolin. Keto mosrakordime thuhet se i dedikohen ne pjesen me te madhe natyres manuale dhe jo me kompjuter, te mbajtjes se te dhenave nga Drejtoria e Pergjithshme e Doganave, per tremujorin e pare te vitit 2009, gje qe e beri te veshtire per Drejtorine te jepte informacion te detajuar per tremujorin e pare. Sistemet e kompjuterizuara te futura ne prill 2009 thuhet se kane permiresuar cilesine e informacionit, te cilen Drejtoria mund ta jape.

Bankers Petroleum, nje nga te dy kompanite e naftes ne prodhim, i dha shifrat e saj te verifikuara nga auditoret e saj, duke dhene nje komfort te rritur se shifrat e raportuara nga kompania ishin te plota. Veshtiresite e vena re nga Rakorduesi nga ana e Drejtorise se Pergjithshme te Doganave ne prodhimin e arketimeve nga renta(ruajalitetet), per nje pjese te periudhes, nga ana tjeter, sugjerojne se mosrakordime mund te vijne nga deklarimi i paplote ose i pasakte i arketimeve nga qeveria, per kete ze.

Diferenca ndermjet pagesave te rentes(ruajalitetet) minerare te deklaruar nga kompanite(93.1 milion leke) dhe arketimeve te deklaruar nga qeveria (92.5 milion leke) ishte 0.6 milion leke, duke perfaqesuar 0.3 perqind te arketimeve totale te deklaruar nga qeveria, prej sektorit minerar.

Qeveria raportoi arketimet nga pese kompanite e sektorit minerar, formularet e mbushur te te cileve u muaren nga Rakorduesi vetem pasi raporti ishte publikuar. Rakorduesi dhe Grupi i Punes rane dakort qe, per te prezantuar shifra konsistente, arketimet e raportuara nga qeveria dhe qe lidhen me keto kompani te mos perfshiheshin ne Raportin EITI. Rakorduesi tha se keto arketime perfaqesonin me pak se 5 perqind te arketimeve totale, te deklaruar nga Shteti.

Pikepamjet e veprimtareve kryesore

Duke u bazuar ne draft raportin e Rakordimit, veprimtaret kryesore ishin te kenaqur qe te gjitha pagesat materiale ishin deklaruar dhe e miratuan raportin me date 4 maj 2011.

Vleresimi i Validuesit

Flukset e perfitimit material u percaktuan nga Grupi i Punes, por nuk kishte percaktim se cila mase e pageses eshte materiale, as edhe se cila diference mes shifrave te kompanive dhe atyre te qeverise duhet konsideruar materiale(kryesore).

Perjashtimi i te dhenave te raportuara nga qeveria, aty ku formularet nuk ishin marre nga kompanite, ndersa nga njera prodhon nje prezantim qe eshte konsistent persa i perket vetem arketimeve te raportuara dhe pagesave ku te dyja palet kishin dhene formularet, nga ana tjeter nuk eshte ne perputhje me kerkesen e pergjithshme te EITI qe te gjitha arketimet dhe pagesat materiale duhet te raportohen, dhe se do te kishte qene e preferueshme te deklaroheshin te gjitha arketimet e raportuara nga qeveria. Raporti thote se shifrat e qeverise u perjashtuan mbi bazen e konsistences, jo te materialitetit (te qenit kryesor) dhe nuk jep tregues te shkalles se arketimeve te perjashtuara mbi kete baze. Prej kesaj, ne kemi vleresuar qe vllimi total i ketyre arketimeve ishte "xxx". Shifrat qeveritare nuk kane qene te konfirmuara ne menyre te pavarur dhe ka diference mes pagesave te raportuara nga kompanite dhe arketimeve te raportuara nga qeveria. Ne mungese te nje percaktimi mbi "materialitetin" (te qenit kryesor), te gjitha pagesat dhe diferencat duhen konsideruar si materiale, keshtu qe nuk eshte e mundur te perfundosh se te gjitha pagesat materiale i jane raportuar Rakorduesit.

Ky tregues nuk eshte arritur.

3.16 Treguesi 16 i Grides: A ishte Grupi Nderinstitucional i kenaqur qe organizata e kontraktuar per te vleresuar shifrat e kompanive dhe te Qeverise veproi ne menyre kaq te suksesshme?

Progresi deri tani

Rakorduesi u zgjodh sipas procedurave te Bankes Boterore dhe caktimi u miratua nga Grupi i Punes. Afati kohor per prodhimin e raportit te pare ishte relativisht i shkurter (Termat e References per Rakorduesin e kerkonin draft raportin te dilte pese jave nga fillimi i punes) dhe 41 nga 46 kompanite prodhuan deklaratat, duke perfshire te gjitha kompanite prodhuese ne kete sferë. Raporti perfundimtar u miratua nga Rakorduesi u zgjodh sipas procedurave te Bankes Boterore dhe caktimi u miratua nga Grupi i Punes me date 4 maj 2011. Nje kopje e shenimeve dhe e listes se pjesemarrësve te ketij takimi eshte atashuar ne Shtojcen 6.

Pikepamjet e veprimtareve kryesore

Te gjithë veprimtaret kryesore ishin te kenaqur me performancen e Rakorduesit.

Vleresimi i Validuesit

Ky tregues eshte arritur.

3.17 Treguesi 17 i Grides: A identifikoi mosrakordime raporti EITI 2009 dhe

a dha rekomandime per veprimet qe duhen ndermarre?

Progresi deri tani

Raporti i rakordimit u prodhua mbi nje baze te agreguar(bashkuar)-kjo nenkupton se ai tregon flukset totale sipas tipit, pa analizen mbi baze kompanie, dhe se mosrakordimet jane perlllogaritur, por nuk i jane atribuar raportimeve individuale te entiteteve. Raporti zbulon diferencat qe ngelen mes shifrave te deklaruar nga kompanite dhe atyre nga qeveria. Mosrakordimet e pazgjdhura persa i perket kompanive te naftes shkojne ne 603.000 dollare(neto) dhe perfaqesojne 7.2 perqind te arketimeve te deklaruar nga Shteti; mosrakordimet e pazgjdhura persa i perket kompanive minerare shkojne ne 4.8 milion Lek, ose 2.5 perqind te arketimeve te deklaruar nga Shteti.

Raporti i rakordimit nuk zbulon te ardhurat e raportuara nga qeveria, aty ku kompanite nuk raportuan pagesa tek Rakorduesi. Raporti deklaroi, persa i perket ketyre kompanive, “aktiviteti i ketyre kompanive eshte shume i kufizuar dhe eshte krejt e pamundur qe kontributi i tyre ne te ardhurat shtetore te jete domethenes”. Qellimi i perjashtimit te te dhenave qeveritare ne keto raste eshte te jesh i afte te identifikosh mosrakordimet mes shifrave te raportuara si nga qeveria ashtu dhe nga kompanite. Megjithate, kriteret e EITI kerkojne publikimin e te gjitha pagesave dhe te ardhurave materiale dhe do te ishte e preferueshme per te ardhurat, e raportuara nga qeveria, qe aty ku kompanite nuk kane raportuar, te ndodheshim te vendosura ne nje vend te veçante ne raport, per hir te transparences dhe qe te lejonin shumen financiare te te dhenave te paçiftuara qe te ishte e shikueshme nga nje lexues i raportit. Kjo eshte veçanerisht nje rast per Shqiperine, ku nuk ka percaktim te “materialitetit”(te qenit kryesor ne pagesa dhe te ardhura) financiar.

Grupi i Punes e miratoi raportin, por nuk mori ndonje vendim lidhur me veprimet qe duheshin ndermarre ne pergjigje te rekomandimeve te Rakorduesit, ose se si diferencat ndermjet deklarave te kompanive dhe te qeverise mund te zgjidheshin, ose se çfare veprimi(nese do te merrej nje i tille) duhej ndermarre ne lidhje me kompanite qe nuk kishin raportuar. Grupi i Punes

po konsideron mundesine qe t'i fuse kompanite qe nuk raportuan ne vitin 2009 ne nje kapitull te veçante ne raportin e vitit 2010. Mosrakordimet po diskutohen me departamentet e qeverise, ne menyre qe aresyet per prodhimin e ketyre mosrakordimeve te mund te identifikohen dhe te shmangen ne te ardhmen. Nuk ka synim qe te kryhet nje ekzaminim i pavarur i mosrakordimeve.

Raporti jep rekomandime lidhur me deklaratat e kompanive dhe te qeverise dhe mbi raportimin e ardhshem EITI.

Pikepamjet e veprimtareve kryesore

Ne nuk i kemi konsultuar veprimtaret kryesore mbi raportin final, i cili u publikua pasi ne ndermorem Validimin.

Vleresimi i Validuesit

Ky tregues eshte arritur.

3.18 Treguesi 18 i Grides: A u be publik Raporti EITI 2009, ne nje menyre

qe te ishte publikisht i aksesueshem, i kuptueshem dhe i teresishem?

Qellimi: EITI perfundimisht eshte teresisht i zbatuar kur Raporti EITI eshte bere publik dhe eshte shperndare gjeresisht dhe diskutuar hapur nga nje rang i gjere veprimtaresh kryesore, Kriteret e EITI kerkojne qe ky Raport te behet publikisht i gjetshem ne nje menyre qe publiku ta gjeje kollaj, ta kuptoje dhe te gjeje te plote.

Prova: Per te miratuar kete tregues, Validuesi duhet te shohe prova qe qeveria ka siguruar qe ky Raport eshte bere publikisht i gjetshem ne menyrat ne perputhje me kriteret e EITI, duke perfshire veprimet e meposhtme:

- prodhimin e kopjeve ne leter te Raportit, te cilat u shperndahen nje rangi te gjere veprimtaresh kryesore, duke perfshire shoqerine civile, kompanite, mediat dhe te tjere;
- berjen e Raportit te gjetshem "online", si dhe berjen publike te vendndodhjes se tij ne adresen ne internet tek veprimtaret kryesore;

- sigurimin qe Raporti eshte i plote dhe qe perfshin te gjithe informacionin e mbledhur si pjese te procesit te Validimit, si dhe te gjitha rekomandimet per permiresim;
- sigurimin qe Raporti eshte i kuptueshem, duke perfshire garantimin qe eshte i shkruar ne nje stil te qarte dhe te aksesueshem, dhe ne gjuhete e duhura;
- sigurimin qe evente te shperndarjes ne mase te lajmit-te organizuara ose nga qeveria, shoqeria civile apo kompanite- te kryhen, ne menyre qe te shperndahet ndergjegjesimi per Raportin”.

Progresi deri tani

Raporti i Rakordimit te Pagesave per 2009-en doli ne formen perfundimtare, i shoqeruar me nje leter perfaqesimi nga ZvMinistri i mETE, me daten 30 prill 2011 dhe ne morem nje kopje, pas miratimit te tij nga Grupi i Punes me 4 maj 2011 dhe nje kopje finale me 5 maj 2011.

Pikepamjet e veprimtareve kryesore

Nuk aplikohet.

Vleresimi i Validuesit

Raporti nuk ishte bere i gjetshem publikisht ne kohen e daljes se Draft raportit te Validimit(5 maj).

Ky tregues eshte arritur.

3.19 A e kane mbeshetur kompanite e naftes, gazit dhe ato minerare zbatimin e EITI?

“*Qellimi*: Ne perputhje me Parimet dhe Kriteret EITI, te gjitha kompanite qe veprojne ne sektoret perkates ne vendet qe zbatojne EITI duhet te deklarojne pagesat qe u bejne qeverise, ne perputhje me formularet e raportimit te rene dakort, si dhe duhet te mbeshesin zbatimin e EITI. Kjo perfshin: te shprehin mbeshetje publike per Nismen; te marrin pjese ose ta mbeshesin procesin shumepalesh; te deklarojne te dhenat e rena dakort, te cilat auditohen sipas standardeve nderkombetare; si dhe te bashkepunojne me Validuesin kur kane pyetje per Formularet e Kompanise.

Prova: Ky tregues nuk kerkon nga Validuesi qe te jape nje vleresim teresor. Validuesi duhet te jape nje vleresim te shkruar te Raportit te Validimit EITI, te bazuar ne Formularet e vetevleresimit te Kompanive(me poshte), te cilat çdo kompani duhet t'i plotesoje. Kur kompanite nuk i plotesojne formularet, Validuesi duhet ta shenoje kete ne Raportin final. Perveç kesaj, validuesi duhet te perfshije ne raportin final çdo informacion te rendesishem mbi kompanine ne fjale, qe eshte bere tashme publik. Kompanise duhet t'i jepet mundesia qe ta kontrolloje kete informacion. Njesoj sikurse perdoren formularet per te permbledhur performancen e kompanise ne raportin EITI, formularet duhet te jene publikisht te gjetshem dhe nje table qe permbledh pergjigjet e kompanise duhet te perfshihet ne Raportin EITI. Validuesi duhet te kontaktoje te gjitha kompanite, te cilave u kerkohet te plotesojne formularet, ne fillim te Validimit, t'i informoje ato per kerkesen per te plotesuar formularin dhe te kerkoje qe formularet e mbushur t'i kthehen Validuesit. Perveç kesaj, Validuesi duhet t'u kerkoje kompanive te komentojne mbi mesimet e marra dhe praktikate me te mira. Kompanite do te kene dy menyra per te bere keto komente:

- kompanite mund te perdorin hapësirën ne formularet e vetevleresimit; ose
- kompanite mund t'i japin prova verbale Validuesit, kur çeshtjet per te cilat kompania do te njoftoje jane te nje natyre sensitive. Validuesi do te permbledhe mesimet dhe eksperiencat e bera anonime ne Raportin e Validimit.

Formulari i vetevleresimit duhet te plotesohet nga kompania si me poshte:

Niveli i vendit:

- secila kompani nafte, gazi apo minerare aktive ne vend, e cila validohet(vleresohet), duhet te plotesoje nje Formular Kompanie ne nivel vendi per nje vetevleresim dhe duhet t'ia dorezoje ate Validuesit.
- Validuesi kombetar do te bashkoje pergjigjet dhe mund te kontaktoje kompanite, nese ato kane pyetje shtese, ose kerkojne informacion te metejshe mbeshtetes. Kompanite duhet t'u pergjigjen pozitivisht ketyre kerkesave.
- Kompanite duhet t'i bejne formularet per secilin vend ku veprojne, te gjetshem publikisht ne adresat e tyre te jashtme ne internet.

Niveli nderkombetar:

- Kompanite qe kane bere zotime nderkombetare per te mbeshtetur EITI, duhet te plotesojne nje formular vetevleresimi te nivelit nderkombetar.
- Formulari i Kompanise nderkombetare duhet te plotesohet nga secila kompani dhe duhet t'i dergohet Sekretariatit EITI, i cili do ta vendose ne faqen ne internet EITI.

- Kompanite po ashtu duhet te japin nje pozicionim te tyre te qarte mbeshtes per EITI ne faqen e tyre ne internet”.

Ka prova te perputhjes me kerkesat e EITI nga kompanite. 41 nga 46 kompani iu pergjigjen kerkeses per informacion ne lidhje me rakordimin e vitit 2009 dhe 21 kompani kthyen formularet e vetevleresimit.

Nje permbledhje e formulareve qe u kthyen tregon:

Formulari

i kthyer Pyetje(formulari i nivelit te vendit)

<i>Kompania</i>		<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	<i>Komente</i>
Albania Chrome(ACR)	v	v	v	v	v	v	Asnje
Alba-Co	v	v	v	v	v	v	Asnje
Albanisa Krypi	v	v	v	v	v	v	Asnje
Alba Canaj	v	v	v	v	v	v	Asnje
Alfa Nikel	v	v	v	v	v	v	Asnje
Ateani	v	v	v	v	v	v	Asnje
Bankers Petroleum	v	v	v	v	v	n/a*	Asnje
Ber-Alb	v	v	v	v	v	n/a	Te dhenat e dorezuara jane audituar nga auditore te pavarur, por jo sipas standardeve nderkombetare
Bledi	v	v	v	v	v	v	Asnje
Geri-Trevi	v	v	v	v	v	v	Asnje
Herbi	v	v	v	v	v	v	Asnje
11 Heronjte Bater Shpk.	v	v	v	v	v	v	Asnje
IEC Visoka	v	v	v	v	v	v	Nuk kemi patur ndonje pretendim ose kontakt nga kompania EITI deri tani
Klosi	v	v	v	v	v	v	Asnje
Koka	v	v	v	v	v	v	Asnje
Mineral Tadri	v	v	v	v	v	v	Asnje
Petromanas Albania	v	v	v	v	v	v	Asnje
RAL	v	v	v	v	v	v	Asnje
Shkemi	v	v	v	v	v	v	Asnje
Tirex Explorations	v	v	v	v	v	v	Asnje
Xhireton	v						Asnje

n/a* = i paaplikueshem

Detaje te metejshmelidhur me kompanite qe u pergjigjen dhe nuk u pergjigjen jepen ne Vellimin 2.

Ne bisedime me perfaqesuesit e kompanive, megjithate, ka nje ndergjegjesim te ulet ndaj objektivave te EITI dhe zbatimit te tij ne Shqiperi. Kompanite ishin ne bllok te pandergjegjesuara per qeverisjen e EITI ne Shqiperi, madje as edhe per anetaresine ose aktivitetet e Grupit te Punes.

Detaje te diskutimeve tona me kompanite jane vendosur gjetiu ne Raport, veçanerisht ne Treguesin 6. Mungesa e kuptimit apo konfuzioni mbi EITI ndoshta del vete ne pergjigjen nga kompania IEC Visoka ndaj formularit te vetevleresimit. Kjo kompani e naftes listohet ne Raportin e Rakordimit si nje kompani qe eshte pergjegjur, por kthen nje pergjigje negative ndaj te gjitha pyetjeve dhe deklaroi se nuk ka patur kontakt per EITI, derisa mori pyetesorin.

Aresyet per pergjigje kontradiktore si ky koment i shkruar-si dhe komentet e njerezve qe ne takuam- jane te paqarta. Eshte e mundur qe komunikimi te kete qene i pakte me kompanine ne fjale, por po ashtu qe komunikimi me kompanite nuk ka qene i mjaftueshem per te rritur ndergjegjesimin e tyre.

Ndersa ndergjegjesimi eshte i ulet, angazhimi per Nismen dhe mbeshtetja ndaj saj jane te veshtira per t'u arritur ne çdo nivel te aresyeshem.

3.20 Çfare hapash jane marre per te vepruar ne baze te mesimeve te marra,

per te trajtuar mosrakordimet dhe per te siguruar qe zbatimi i EITI te jete i qendrueshem?

Qellimi: Prodhimi dhe shperndarja e nje Raporti EITI nuk eshte fundi i zbatimit te EITI. Vlera vjen nga procesi po aq sa nga produkti dhe eshte thelbesore qe mbi mesimet e marra gjate zbatimit te veprohet, qe mosrakordimet e identifikuar ne Raportin EITI te trajtohen dhe qe zbatimi i EITI te vihet ne nje rruge te qendrueshme.

Prova: Validuesi duhet te shohe prova qe nje mekanizem rishikimi eshte vendosur, i cili merr ne konsiderate qellimin e percaktuar me siper. Validuesi duhet te komentoje per kete ne Raportin e Validimit.

Eshte shume shpejt per te komentuar per kete çeshtje, duke patur parasysh qe raporti i rakordimit u miratua vetem dy dite me pare, ende nuk eshte publikuar dhe nuk eshte shperndare. Nuk ka patur mundesi per rekomandime ne kete raport, per t'u konsideruar, si dhe sigurisht aspak kohe per to per t'u zbatuar.

Ne kemi permendur fusha qe pengojne qendrueshmerine e zbatimit te EITI, nepermjet vleresimit tone per Treguesit e Grides, si dhe i kemi permbledhur komentet tona ne konkluzionet, se bashku me rekomandimet. Keto te fundit jane ne fakt mesimet e nxjerra nga zbatimi dhe formojne nje baze per Grupin e Punes se ALBEITI qe te procedoje.

Kerkohet nje Plan Pune i ri(plani i tanishem shkon deri ne vitin 2011), duke perfshire veprimet e percaktuara nga Grupi i Punes, ne pergjigje te rekomandimeve te ndryshme te bera dhe nga vendimet e tij lidhur me zbatimin e EITI ne Shqiperi.

4. GRIDA E VALIDIMIT(VLERESIMIT)

Vleresimi yne nese Treguesit jane arritur tregohet me poshte. Duhet shenuar se Shqiperia konsiderohet t'i kete arritur te kater treguesit e pare ne kohen kur u pranua nga Bordi i EITI si nje Vend Kandidat.

Treguesi i Grides		Nese eshte arritur
	NENSHKRIMI	
i.	A ka nxjerre Qeveria nje deklarate publike pa ekuivoqe per qellimin e saj qe ta zbatoje EITI-n?	v
ii.	A eshte Qeveria e perkushtuar qe te punoje me shoqerine civile dhe me kompanite per zbatimin e EITI?	v
iii.	A ka caktuar Qeveria nje individ te larte per te drejtuar zbatimin e EITI?	v

iv.	A eshte publikuar dhe bere gjeresisht i arritshem nje Plan Veprimi teresisht i kostuar(me kostot perkatese), i cili te permbaje objektiva te matshem, nje plan kohor per zbatimin dhe nje vleresim per kufizimet ne kapacitete(Qeveri, sektor privat dhe shoqeri civile)?	v
	PERGATITJA	
v.	A ka themeluar Qeveria nje grup nderinstitucional per te mbikqyrur zbatimin e EITI?	x
vi.	A eshte shoqeria civile e angazhuar ne proces?	x
vii.	A jane kompanite te angazhuara ne proces?	v
viii.	A hoqi Qeveria ndonje pengese ne zbatimin e EITI?	v
ix.	A jane miratuar formatet e raportimit?	v
x.	A eshte i kenaqur Grupi Nderinstitucional me organizaten e caktuar per te rakorduar shifrat?	v
xi.	A ka siguruar Qeveria qe te gjitha kompanite do te raportojne?	v
xii.	A ka siguruar Qeveria qe raportet e kompanise te jene te bazuara ne llogari te audituara sipas standardeve nderkombetare?	x
xiii.	A ka siguruar qeveria qe raportimet qeveritare jane te bazuara ne llogari te audituara mbi standarde nderkombetare?	v
	DEKLARIMI	
xiv.	A iu dhane te gjitha pagesat materiale te naftes, gazit dhe mineraleve qe kompanite i bejne Qeverise, organizates se kontraktuar per te rakorduar shifrat dhe per te prodhuar Raportin EITI?	x
xv.	A iu dhane te gjitha te ardhurat e naftes, gazit dhe mineraleve te arketuara nga Qeveria(“te ardhurat”) organizates se kontraktuar per te rakorduar shifrat dhe per te prodhuar Raportin EITI?	x
xvi.	A ishte Grupi Nderinstitucional i kenaqur qe organizata e kontraktuar per te vleresuar shifrat e kompanive dhe te Qeverise veproi ne menyre kaq te suksesshme?	v
xvii.	A identifikoi mosrakordime raporti EITI 2009 dhe a dha rekomandime per veprimet qe duhen ndermarre?	v
	SHPERNDARJA	
xviii.	A u be publik Raporti EITI 2009, ne nje menyre qe te ishte: * publikisht i aksesueshem * i teresishem, dhe * i kuptueshem ?	x

Shenja “v” =tregues i arritur; shenja “x”=tregues i paarritur

5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

5.1 Konkluzionet e Validuesit mbi zbatimin e EITI ne Shqiperi

Pati aktivitet energjik pas deklarates se aderimit ne 2009-en, me nje deklarate publike, workshope trajnimi, themelimin e nje Grupi Nderinstitucional e me rradhe.

Dhe ka patur perpjekje te konsiderueshme qe ne fillim te vitit 2011 mbi çeshtje qe lidhen me EITI, mbeshtetur nga nje perkushtim i forte i qeverise, i shprehur nga Kryeministri dhe nga Kryetari i Grupit te Punes, per kryerjen e rakordimit dhe realizimin e procesit te validimit. Prodhimi i raportit te rakordimit te pagesave ne afatin kohor ne te cilin u krye ishte rezultat i nje pune te madhe te lavderueshme nga agjensite qeveritare dhe kompanite e perfshira ne rangun e ushtrimit.

Per gjate pjeses me te madhe te vitit 2010, megjithate, u be pak progres. Aktiviteti nuk ishte i qendrueshem ne te kaluaren, gjate gjithë periudhes nga aderimi deri me sot, dhe kjo do te thote se qendrueshmeria e zbatimit ne te ardhmen ka nevojë te ekzaminohet me kujdes.

Financimi

ZvMinistri i METE shprehu perkushtimin e qeverise ndaj Nismes dhe synimin per te siguruar qe fonde te pershtatshme te jepen nga qeveria. Ai sugjeroi qe sektori privat mund te jape kontribute. Ne folem me Andre Ufer nga Banka Boterore, i cili konfirmoi se ka financim nga Banka per pjesen qe ngelet te vitit 2011, me mundesine qe fondi mund te zgjatet pas kesaj date.

Grupi Nderinstitucional

Ne kemi komentuar ne raportin tone mbi perberjen dhe veprimtarine e Grupit te Punes.

Ne nuk kemi mundur te percaktojme anetaresine dhe nuk mendojme se ka komunikim te pershtatshem mes grupeve te veprimtareve kryesore(stakeholders), per shembull, prej perfaqesuesve ne Grupin e Punes tek grupet e tyre te interesit apo perkatesise dhe anasjelltas. Si dhe ne teresi, me komunikimin e Grupit te Punes më gjeresisht me gjithë Shqiperine.

Nuk ka terma te references per vete Grupin, gje qe do te thote se anetaret nuk jane te ndergjegjesuar per detyrat dhe te drejtat e tyre si anetare te Grupit te Punes, dhe keshtu nuk mund t'i plotesojne si duhet ato.

Anetaresia e Grupit u zgjerua pak perpara ose gjate vizites sone, per te rritur perfaqesimin nga kompanite dhe nga shoqeria civile, megjithese procesi me ane te te cilit keta anetare shtese u perzgjodhen nuk eshte shpjeguar.

Megjithë keto mangesi ne angazhim mes veprimtareve kryesore, Shqiperia porositi, prodhoi dhe miratoi nje Raport EITI per vitin 2009.

Promocioni dhe publikimi i EITI

Pati nje nivel te ulet ndergjegjesimi per EITI dhe qellimet e tij mes njerezve qe ne takuam, nga te gjitha grupet e veprimtareve kryesore. Gjate vitit 2011, ka patur disa dalje ne televizion dhe ka plane per te komunikuar raportin e rakordimit(ende jo per ta zbatuar, sepse raporti sapo eshte miratuar) dhe per te themeluar nje faqe te vecante interneti per EITI Shqiperia. Megjithate, publiciteti lidhur me EITI ka qene i kufizuar deri tani, dhe ndergjegjesimi i pergjithshem i ulet qe gjetem eshte ne perputhje me nivelin e ulet te publicitetit dhe shperndarjes se informacionit qe nga aderimi.

Konkluzioni

Ne e kemi plotesuar Griden(Listen) e Validimit, duke dhene vleresimin tone per progresin e bere perkundrejt secilit Tregues, mbeshtetur ne vleresimin tone pershkrues. Kemi bere nje numer rekomandimesh ne seksionin 5.2. Shume nga rekomandimet mund te behen efektive brenda nje kohe te shkurter, por veprimi i tyre konkret do te kerkoje kohe, perpara se sa nje gjykim te arrihet.

Prandaj dhe, ne besojme se Shqiperia ka bere progres domethenes, por nuk mund te gjykohet si e perputhur, derisa te kete prova te metejshme te nje zbatimi ne vijueshmeri dhe te qendrueshem.

5.2 REKOMANDIME PER ZBATIMIN E METEJSHEM TE EITI NE SHQIPERI

Ne driten e observimeve tona lidhur me zbatimin e EITI ne Shqiperi, ne bejme nje numer rekomandimesh, te cilat do ta permiresonin zbatimin e ardhshem dhe ne vijueshmeri. Keto permbliidhen ne pese tematika:

1. Grupi Nderinstitucional
2. Plani i Punes
3. Ndertimi i kapaciteteve dhe komunikimi
4. Raporti i Rakordimit EITI 2010
5. Te tjera

1. Grupi Nderinstitucional

- i. Perberja e MSG(Grupit) duhet te perfaqesoje drejtesisht grupet e ndryshme te veprimtareve kryesore.

Ne nje grup ku votimi i detyrueshem me shumice vote eshte rregull(sikurse per Grupin e Punes ALBEITI), perfaqesimi nga qeveria me 12 perfaqesues, plus Kryetarin e Grupit nga qeveria mund te kerkoje 6 perfaqesues nga kompanite dhe 6 perfaqesues nga shoqeria civile per t'u konsideruar, ne menyre qe interesat e ketyre grupeve te veprimtareve kryesore te perfaqesohen drejtesisht.

- ii. Procedurat per caktimin e MSG(Grupit Nderinstitucional) duhet te dalin publikisht dhe te respektohen ne praktike.
- iii. Anetaresimi ne MSG duhet te gjendet publikisht.
- iv. Termat e references per MSG duhet te miratohen dhe publikohen.
- v. Procedurat qe qeverisin veprimtarine e MSG duhet te shkruhen dhe t'u jepen te gjithe anetaresve te MSG. Ato duhet te mbulojne:
 - kuorumin e kerkuar per takimet
 - menytrat e njoftimit per takimet
 - kerkesat e miratimit per vendimet e MSG.

Procedurat per qarkullimin dhe miratimin e minutave(shenimeve) te takimeve(per shembull, publikimin e nje permbledhjeje te biznesit per çdo takim) mund te konsiderohen.

2. Plani i Punes

MSG duhet te pergatise dhe ne menyre periodike te pershtase nje Plan Pune per tre vitet e ardhshme, me nje baze rrjedhese, duke filluar nga periudha 2011-2013. Plani i Punes duhet te plotesoje Kerkesen 5 nga Rregullat EITI 2011 dhe progresi duhet monitoruar nga MSG ne menyre te rregullt, me veprime korrigjuese te ndermarra kur duhet.

Targete(objektiva) te qarta dhe te detajuara, me vleresime kostosh dhe burime financimi duhet te vendosen ne Plan, per te mundesuar realizimin e objektivave, te cilat duhen matur dhe monitoruar.

Plani duhet te behet i njohur gjeresisht, per shembull te publikohet ne faqen kombetare te EITI ne internet dhe ne faqet ne internet te ministrive te linjes, ne mediat e printuara ose ne vende qe jane gjeresisht te aksesueshme nga publiku.

3. Ndertimi i kapaciteteve dhe komunikimi

Kufizime potenciale te kapaciteteve duhen identifikuar zyrtarisht. Draft Plani i Pune i dhene nuk permban ndonje veprim lidhur me kete aktivitet. Ne vijim te diskutimeve mes nesh dhe Sekretariatit te ALBEITI, draft Plani i Punes duhet te perditesohet, per te perfshire vleresime formale te kufizimeve ne kapacitete.

Komunikimi lidhur me EITI kerkon permiresim dhe kapaciteti i veprimtareve kryesore per te kryer dhe per te perfitur nga komunikimi duhet te permiresohet. MSG duhet te kerkoje asistencë ne projektimin e nje programi per t'u kryer ne gjysmen e dyte te vitit 2011 dhe me tej, per te rritur kapacitetet mes veprimtareve kryesore dhe per te komunikuar lidhur me EITI.

Publikimi i raportit EITI 2009 duhet te jete pjese e ketij programi.

4. Raporti i rakordimit EITI 2010

Ne driten e vleresimit tone qe Shqiperia ke bere progres domethenes, por ende nuk eshte e perputhur, ne rekomandojme qe MSG duhet te prodhoje nje raport rakordimi EITI 2010 nga fundi i vitit 2011. Ne pergatitjen per kete raport, MSG duhet te kete parasysh rekomandimet e bera nga Rakorduesi dhe duhet te ndermarre veprime per te qene ne linje me te gjitha kerkesat EITI lidhur me prodhimin e raportit te rakordimit. Raporti i 2010-es duhet po ashtu te mesoje nga procesi i raportit te 2009-es, me vemendje te veçante ne:

- i. zgjerimin e rangut te kompanive te perfshira
- ii. marredhenien e deklarave te kompanive dhe qeverise me llogarite e audituara sipas standardeve nderkombetare
- iii. konsultimin me veprimtaret kryesore lidhur me nivelin e pagesave per t'u perfshire
- iv. percaktimin e “materialitetit”(te qenit kryesor) te pagesave dhe te diferencave
- v. kohe e mjaftueshme duhet t'i jepet pergatitjes, mbledhjes se te dhenave dhe rakordimit e publikimit te raportit.

5. Termat e references dhe rregullat e procedures se MSG

Sekretariati i ALBEITI na dha ne draft termat e rishikuara te references dhe rregullat e procedures per MSG. Ne e inkurajojme Sekretariatit te konsideroje ndryshime ne fushat e meposhtme:

1. Procedura per caktimin e perfaqesuesve jo-qeveritare duhet te specifikohet.
2. Procedurat e njoftimit(te MSG) per ndryshimin e perfaqesuesve duhet te vendosen.
3. Kuptimi i “merr pjese” ne Nenin 5, paragrafi 4 duhet te theksohet. Te gjitha keto pale lejohen te flasin, por prezumohet se nuk kane te drejte vote, etj. Kjo duhet te vendoset.
4. Nen rregullat e kuorunit te propozuar(Neni 6, paragrafi 2), nuk ka kerkese perperfaqesuesit e secilit grup(qeveri, kompani, shoqeri civile) qe te marre pjese. Kjo nenkupton se vendimet mund te merren pa pjesemarrjen te te gjitha grupeve te perfaqesimit. Ne besojme se nje prani e secilit nga grupet duhet te kerkohet per te gjitha takimet e MSG, qe keto takime te kuorohen(te arrihet kuorumi).
5. Neni 6, paragraf duplikon Nenin 5, paragrafi 4.
6. Neni 4-kompetencat e MSG- duhet te specifikojte qe MSG eshte pergjegjese per dhe kompetente ne te gjitha zerat e kerkuar si minimum nga EITI, duke perfshire:
 - a. miratimin dhe rishikimin e Planit te Punes EITI
 - b. zgjedhjen e nje auditori per te marre persiper auditime, kur te dhenat e dorezuara per rakordim nga kompanite apo qeveria nuk jane tashme te bazuara ne te dhena te audituara sipas standardeve nderkombetare
 - c. zgjedhjen e nje organizate per te kryer rakordimin EITI çdo vit
 - d. zgjedhjen e nje organizate per te kryer Validimin EITI
 - e. mbikqyrjen e aktiviteteve te tjera te nevojshme per te arritur dhe mbajtur perputhshmerine.

Sekretariati ALBEITI mund te doje te marre observime nga Sekretariati Nderkombetar i EITI mbi çeshtjet per t’u perfshire.

Mund te jete ne ndihme te MSG, veçanerisht nje grup si i tanishmi me nje anetaresi prej 17 vetash, qe te kryeje disa aktivitete duke krijuar nengrupe te perkohshme, zakonisht me anetaresi nga secili grup interesi. Rregullat e procedures duhet te permbajne nene per te tilla rregullime.

6. Angazhimi i kompanive

Konfuzioni qe pame lidhur me perfaqesimin e kompanive ne Grupin e Punes dhe ndergjegjesimi i ulet per EITI dhe qellimet e tij mes kompanive, keto kane nevojte te trajtohen. Grupi i Punes ne menyre kolektive dhe perfaqesuesit e kompanive ne Grupin e Punes ne veçanti, duhet te sigurojne se do te kete komunikim te rregullt me kompanite nxjerrese mbi leshtje te interesit, nen EITI. Po ashtu, kompanite duhet te nxiten qe te marrin pjese ne workshope ose aktivitete te tjera te organizuara nga Grupi i Punes, dhe ne teresi te promovojne ndergjegjesimin per EITI.

7. Kompanite ne rang

Rakordimi i vitit 2009 i perfshiu te gjitha kompanite e naftes dhe synoi te perfshinte kompanite me te medha minerare, duke mbuluar 60% te prodhimit.

EITI bazohet tek arketimet e qeverise dhe pagesat nga kompanite ne industrine nxjerrese.

Ne rekomandojme qe raportet e ardhme te perdorin masa financiare per te percaktuar rangun e mbulimit te kompanive nga rakordimi dhe qe Sekretariati i ALBEITI te rregulloje punen e percaktimit te rangut, qe duhet kryer.

8. Deklaratat qeveritare EITI

Deklaratat qeveritare per rakordimin EITI 2010 dhe me tej duhet te çertifikohen nga Auditori i Qeverise, si te bazuara tek llogari te audituara sipas standardeve nderkombetare.

9. Çeshtje te tjera

- i. Nuk eshte konsistente t'u kerkosh disa kompanive me ligj qe te raportojne sipas EITI, ndersa lejon te tjera te raportojne ne menyre vullnetare. Legjislacioni duhet te rregullohet qe t'u kerkoje kompanive te naftes te plotesojne kerkesat e EITI, mbi te njejtat baza ligjore si kompanite minerare.

SHTOJCAT

1. Lista e kompanive qe u pergjigjen
2. Pyetesoret e vevleresimit te kompanise
3. Draft Plani i Punes ALBEITI(i rishikuar ne qershor 2011)

4. Indeksi dhe letrat e emerimit per personat e caktuar si anetare te Grupit te Punes
5. Draft Termat e References dhe rregullat e procedures per Grupin e Punes te ALBEITI
6. Minutat(shenimet) dhe lista e pjesemarresve per takimin e Grupit te Punes me 4 maj 2011, i cili miratoi raportin e Rakordimit 2009.

Me perjashtim te Shtojces 1 dhe Indeksit te Shtojces 2, shtojcat e tjera jane lidhur veç.